

**SALI KADRIA**

### **MBI DISA ÇËSHTJE TË KRYENGRITJES SHQIPTARE TË VITIT 1912**

Kryengritja shqiptare e vitit 1912 përbën një pikë kulmore të lëvizjes autonomiste shqiptare dhe etapën finale të përpjekjeve të nacionalizmit dhe kombit shqiptar nën Perandorinë Osmane. Ajo pati ndikim të rëndësishëm jo vetëm për ngjarjet historike në atë periudhë, por gjithashtu ushtroi ndikim edhe në rrjedhën historike të shqiptarëve pas shpalljes së shtetit të pavarur shqiptar. Për shkak të rëndësisë së veçantë që paraqet, ajo është trajtuar në mënyrë të gjerë në studimet historike brenda dhe jashtë vendit, prandaj kjo trajtesë do të fokusohet në disa prej çështjeve kryesore të Kryengritjes së vitit 1912.

#### **Pse shqiptarët shkuan drejt kryengritjes në vitin 1912?**

Faktori kryesor që nxiti shqiptarët të hidheshin në Kryengritjen e vitit 1912 ishte gjendja e vështirë në të cilën ata ndodheshin. Pas fitores së Revolucionit Xhonturk të vitit 1908 e deri në vitin 1912, qeveria xhonturke i acaroi marrëdhëniet jo vetëm me nacionalistët shqiptarë por edhe me pjesën e gjerë të popullsisë shqiptare. Megjithë kontributin e çmuar që dhanë për ardhjen në pushtet të xhonturqve, shqiptarët nuk arritën të fitonin një pozitë të barabartë me popujt e tjerë të kësaj perandorie. Qeveria xhonturke, jo vetëm që nuk solli përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe shoqërore të shqiptarëve, por përkundrazi u shtoi atyre barrën e taksave, u mori armët që u duheshin për vetëmbrojtje, si dhe të gjithë të rinjtë shqiptarë u detyruan të kryenin shërbimin ushtarak. Valës së protestave të shqiptarëve, qeveria xhonturke iu përgjigj duke dërguar në Shqipëri forca të shumta ushtarake, të cilat i trajtuan shqiptarët si të ishin një popull armik<sup>1</sup>. Nga viti 1909 e më pas,

---

<sup>1</sup> Haus - Hof und Staats Archiv, Wien Politisches Archiv Albanien (më tej: HHStA.PA.A.) në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 22-6-657, Një broshurë lidhur me çështjen shqiptare që pritej të botohej nga baroni Leopold von

marrëdhëniet ndërmjet nacionalizmit turk dhe nacionalizmit shqiptar shkuan në një pikë kritike, sa ishte e vështirë rikthimi i tyre në gjendjen e mëparshme.

Shkak për acarimin e marrëdhënieve midis dy palëve u bë ideologjia e “otomanizmit” dhe e politikës centralizuese të ndërmarrë nga xhonturqit. Ideologjia e “otomanizmit” u përhap nga xhonturqit mbështetur edhe mbi parimin e panislamizmit. Kjo politikë fshihte brenda saj idenë e “turqizimit”, pra, të sheshimit të identitetit të kombësive të tjera me synimin që popullsia turke të mbetet sunduese e Perandorisë Osmane. Qëllimi i xhonturqve binte në kundërshtim me aspiratën për autonomi kombëtare të shqiptarëve. Prandaj, ai u bë faktori kryesor që nxiti më tepër dhe në mënyrë më të shpejtë përhapjen e ideologjisë kombëtare në mesin e shqiptarëve. Duke parë zhvillimin e shpejtë të ndërgjegjes kombëtare tek shqiptarët, autoritetet xhonturke vendosën që me forcën e armëve ta zgjidhnin “përfundimisht” çështjen shqiptare. Goditja kryesore u drejtua kundër elitës politike, sepse drejtuesit xhonturq mendonin se përballë tyre ndodheshin shqiptarët “tradhëtarë”, [nacionalistët shqiptarë – S. Kadria], të cilët nën ndikimin e shteteve perëndimore synonin shpërbërjen e Perandorisë Osmane<sup>2</sup>. Vala e sulmeve u drejtua edhe ndaj popullsisë së thjeshtë shqiptare. Pa kaluar shumë kohë nga ardhja e tyre në pushtet, xhonturqit vendosën ndërmarrjen e masave të ashpra në kuadër të programit të tyre politik, me të cilat synonin “pakësimin e divergjencave” dhe “rrafshimin e kontradiktave” ndërmjet kombësive të ndryshme brenda Perandorisë Osmane. Ndërmarrja e fushatës së çarmatimit me dhunë nga qeveria xhonturke, ishte një akt që shkonte kryesisht kundër shqiptarëve. Në radhë të parë, ajo synonte t’u jepte atyre për të kuptuar se në rast se ata kundërshtonin, ajo nuk do të hezitonte të përdorte armët për të treguar “forcën” e shtetit osman. Nga ana tjetër, çarmatimi synonte t’i linte të pambrojtur shqiptarët kundrejt sulmeve apo ndonjë pushtimi të mundshëm nga ana e shteteve fqinje, që ata t’i përkuleshin asaj për ndihmë. Kjo masë synonte t’u hiqte atyre mjetin më të çmueshëm në luftën e tyre për ekzistencë. Qeveria xhonturke i shihte shqiptarët me përbuzje si një popull i “prapambetur”, të cilët ishin kthyer në një

Chlumencky me titullin: “Xhonturqit dhe Shqipëria” e paraqitur prej një diplomati austro-hungarez (më tej: a-h) i paidentifikuar, korrik 1912.

<sup>2</sup> *Po aty*, Vj. 22-18-1825, Raport nga një diplomat a-h i paidentifikuar, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Stamboll, 5 qershor 1912.

pengesë për shtetin osman. Qëndrimi i ashpër i qeverisë xhonturke ndaj shqiptarëve ishte një politikë e gabuar. Kjo politikë ftohu marrëdhëniet e shumicës së shqiptarëve me drejtuesit e shtetit osman. Nga gjendja e vështirë që u krijua prej xhonturqve, tek nacionalistët u krijua mendimi se shqiptarët duhej të bashkoheshin se po shkonin drejt fundit të tyre si komb, prandaj atyre nuk u kishte mbetur rrugë tjetër, ose të ngriheshin kundër xhonturqve ose të pranonin përfundimisht nënshkrimin e plotë ndaj tyre<sup>3</sup>.

Përdorimi i metodave të egra kundër popullsisë shqiptare arriti deri aty sa “nji mizori pa kurrfarë frëni mbretonte në Shqypni”<sup>4</sup>. Politika e terrorit e ndjekur nga xhonturqit ndaj shqiptarëve pati dy rrjedhoja pozitive që shkuan në favor të nacionalizmit shqiptar. Së pari, ajo nxiti unifikimin e grupit të deputetëve shqiptarë në Parlamentin Osman. Së dyti, rriti kohezionin ndërmjet elitës politike shqiptare dhe shqiptarëve. Thirrjet e deputetëve shqiptarë për ndërprerjen e masave të terrorit ndaj popullsisë shqiptare dhe gjetjen e një gjuhe kompromisi ndërmjet dy palëve ranë në vesh të shurdhër. Në këto rrethana, tek përfaqësuesit politikë shqiptarë u krijua bindja se ideja e kryengritjes së armatosur nuk mbështetej më vetëm nga një grusht idealistësh, por ajo ishte kthyer në një qëllim të paktën për shumicën e shqiptarëve<sup>5</sup>.

Faktori i dytë i rëndësishëm që nxiti fillimin e Kryengritjes shqiptare të vitit 1912 ishte pozita e vështirë ndërkombëtare në të cilën ndodhej Perandoria Osmane. Sulmi i Italisë kundër Perandorisë Osmane në vjeshtë të vitit 1911, ishte një shenjë e qartë për shqiptarët se nëse krijoheshin rrethanat e përshtatshme, Fuqitë e Mëdha do të braktisnin politikën e ruajtjes së “status quo-së” së Perandorisë Osmane. Në rrethet patriotike shqiptare ishte i pranishëm mendimi se Lufta Italo-Osmane do të çonte në një luftë ballkanike, e cila do të shkatërronte Perandorinë

<sup>3</sup> Arkivi *Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 54, Viti (më tej: V.) 1912, Dosja (më tej: D.) 67/2, fl. 155-156, Letër e Luigj Gurakuqit drejtuar Sotir Koleas, Nicë, 30 janar 1912; Eqrem bej Vlora, *Kujtime (1885-1925)*, përkthyer nga Afrim Koçi, Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit, 2003, f. 236.

<sup>4</sup> Hasan Prishtina, *Nji shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912*, Shkodër: Shtypshkronja Franciskane, 1921, f. 5; *Hasan Prishtina – Përmbledhje dokumentesh (1908-1934)*, përgatitur nga Kujtim Nuro dhe Nezir Bata, Tiranë: “8 Nëntori”, 1982, f. 52-53.

<sup>5</sup> Lek Zeza, *Çeta e Studentëve Shqipëtarë të Selanikut*, Tiranë: Shtypshkronja “Atdheu”, 1944, f. 14.

Osmane dhe do t'i vinte shqiptarët përpara rrezikut të copëtimit të atdheut të tyre<sup>6</sup>. Nga ana tjetër, nacionalistët shqiptarë shihnin se dobësia e brendshme e shtetit osman u kishte hapur shtegun për ndërhyrje edhe shteteve ballkanike, të cilat synonin realizimin e platformave të tyre kombëtare, duke nxitur popullsitë minoritare që ndodheshin brenda Perandorisë Osmane që të bashkoheshin me shtetet e tyre kombëtare. Elita politike dhe shqiptarët në përgjithësi e kishin të qartë se reformat që synohej të realizoheshin në pjesën ballkanike të shtetit osman, të nxitura kryesisht nga Rusia shkonin kundër interesave kombëtare të shqiptarëve, sepse prej tyre do të përfitonin më tepër kombësitë e tjera. Shtypi shqiptar konstatonte me të drejtë në fillim të vitit 1912: “Cili shqiptar qi din shka asht politika, nuk shef se shka janë tuej punue Serbi, Bullgari, Austria, Italia, Mali i Zi e Greqia ndër vende t’ona. T’gjith kta qi përmenden kan hap gojin me shkye nji copë t’atdheut t’onë”<sup>7</sup>.

Për t'i dalë përpara gjendjes së vështirë të krijuar në trojet shqiptare nga qeveria xhonturke, drejtuesit politikë shqiptarë që vepronin në Stamboll e kanalizuan veprimtarinë e tyre politike në dy drejtime kryesore: Së pari, gjatë vitit 1911 dhe në fillim të vitit 1912, deputetët shqiptarë u përpoqën të gjenin një gjuhë kompromisi me drejtuesit e qeverisë xhonturke. Në janar të vitit 1912, ata paraqitën një kërkesë për të ftuar në interpelancë drejtuesit e qeverisë xhonturke. Në këtë seancë, ata kërkuan ndërmjet të tjerave që të ndalohej dërgimi i trupave të reja osmane në vilajetin e Shkodrës; të ndaloheshin ndëshkimet trupore dhe burgosjet e paligjshme ndaj shqiptarëve, të cilat fyenin rëndë dinjitetin dhe traditën e shqiptarëve; si dhe të ndërpriteshin djegiet e shtëpive të malësorëve që ishin arratisur në Mal të Zi. Së dyti, drejtuesit politikë shqiptarë u përpoqën të gjenin shtigje të reja bashkëpunimi me faktorë të tjerë politikë brenda Perandorisë Osmane, të cilët kundërshtonin politikën e ndjekur nga xhonturqit<sup>8</sup>.

Në këto rrethana, deputetë nacionalistë shqiptarë, si Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Myfit Libohova e të tjerë u afruan me opozitën turke “Liri e Marrëveshje” (Hyriet ve Itilaf). Ata vendosën të bashkëpunonin

<sup>6</sup> *Historia e Popullit Shqiptar – Rilindja Kombëtare, Vitet 30 të shek. XIX - 1912*, vëll. II, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: “Toena”, 2002, f. 461.

<sup>7</sup> “Shqipnija e Turqia”, në *Shkupi*, nr. 16, Shkup, 17/30 janar 1912, f. 2.

<sup>8</sup> *Historia e Shqipërisë (vitet 30 të shek. XIX - 1912)*, vëll. II, botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë: 1984, f. 464-465.

me përfaqësuesit e kësaj opozite mbështetur në dy pika të përbashkëta. Së pari, drejtuesit politikë shqiptarë mendonin se me rrugën që po ndiqte qeveria xhonturke, shumë shpejt Perandoria Osmane do të shkonte drejt humnerës, për pasojë edhe trojet shqiptare do të copëtoheshin nga fqinjët. Së dyti, të dy palët kishin arritur në përfundimin se “i vetmi shpëtim për t’ a pritë ket rrezik asht të largumunit e partis së turqvet të rij nga fuqija”<sup>9</sup>. Afrimi i shqiptarëve me opozitën turke ngjalli tek xhonturqit një acarim të brendshëm. Ky acarim i shtyu ata drejt ndërmarrjes së hapave më të gabuar në qëndrimin e tyre ndaj shqiptarëve. Sulmi fizik i deputetit xhonturk Dervish Beu kundër deputetit të moshuar shqiptar Ismail Qemalit u konsiderua nga shqiptarët si një fyerje e rëndë kombëtare, e cila duhej të paguhej shtrenjtë<sup>10</sup>. Ky akt ndikoi që të forcohej më tepër uniteti në radhët e deputetëve shqiptarë. Duke parë se xhonturqit nuk kishin ndërmend të hiqnin dorë nga rruga e tyre, Hasan Prishtina ishte i pari nacionalist shqiptar që deklaroi publikisht në Parlamentin Osman në seancën e datës 11 janar 1912, se nëse kjo qeveri nuk ndryshonte kursin që kishte nisur, “n’ t’ gjith anet do shpallet revolucia dhe unë do jem një flamurtar mbajtes (bajraktar) i kësaj”<sup>11</sup>.

Një faktor i rëndësishëm që nxiti shqiptarët drejt veprimeve kryengritëse ishin përpjekjet e qeverisë xhonturke gjatë zgjedhjeve parlamentare të pranverës 1912 për të penguar me çdo kusht zgjedhjen e kandidatëve kombëtarë shqiptarë si deputetë në Parlamentin Osman. Një pjesë e deputetëve që nuk fituan në këto zgjedhje, si Ismail Qemali, Hasan Prishtina dhe Basri Beu filluan të zhvillonin një fushatë agjitacioni kundër politikës së ndjekur nga qeveria xhonturke. Një ngjarje tjetër, e cila i acaroi shqiptarët edhe më tepër ishte udhëtimi në viset shqiptare gjatë muajit mars, i Komisionit të reformave me në krye ministrin e Brendshëm Haxhi Adil Beu. Misioni i tij ishte kinse për të përmirësuar gjendjen e popullsisë shqiptare, por në të vërtetë ai kishte ardhur për të larguar shqiptarët nga lëvizja kryengritëse dhe për të nxitur ata që të votonin për Partinë “Bashkim e Përparim”. Gjatë vizitës së tij, ai ishte i interesuar kryesisht për financimin e ngritjes së ndërtesave qeveritare,

<sup>9</sup> H. Prishtina, *Nji shkurtim kujtimesh...*, f. 15.

<sup>10</sup> *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. II, f. 461.

<sup>11</sup> “Oratorët Shqipëtarë”, në *Koha*, nr. 2-22, Korçë, 13 janar 1912, f. 2; *Shkupi*, nr. 27, Shkup, 15/ 28 maj 1912, f. 2; H. Prishtina, *Nji shkurtim kujtimesh...*, f. 5.

ndërtimin e rrugëve për transportimin e trupave dhe ngritjen e karakolleve të xhandarmërisë osmane<sup>12</sup>.

Ndërkohë, shqiptarët kishin nevoja të tjera imediate për zhvillimin e tyre. Për ata ishte e domosdoshme funksionimi normal i jetës dhe i veprimtarisë ekonomike të përditshme, ndërtimi i shtëpive, përmirësimi i gjendjes së rrugëve, çelja e shkollave të reja në viset ku nuk ekzistonin dhe mësimi i gjuhës shqipe në këto shkolla, zgjedhja e atyre deputetëve që gëzonin mbështetjen e popullsisë, ndalimi i aksionit për mbledhjen e taksave, të armëve dhe i rekrutimit me forcë në ushtri i shqiptarëve. Shqiptarët ishin të gatshëm të paraqisnin edhe kërkesa më të përparuara politike, që synonin “autonomi të plotë ose vetëqeverisje”<sup>13</sup>. Prandaj, nuk ishte rastësi, që bejlerët shqiptarë të krahinës së Gjakovës i deklaruan ministrit të Brendshëm se “shqipëtarët sa do që janë besnikë në myslimanizma, po kanë vetëdije të fortë, që janë një komp i veçantë, dhe që qeveria nuku duhet t’i prurë ndalime përparimit të kombësisë tyre”<sup>14</sup>. Autoritetet xhonturke nuk lanë pa përdorur lloj-lloj mjetesh dhe mënyrash për të mbajtur larg popullsinë shqiptare nga deputetët nacionalistë shqiptarë. Për shkak të këtyre veprimeve shumica e drejtuesve nacionalistë shqiptarë së bashku me mbështetësit e tyre dolën në male, ndërsa popullsia e krahinave të veçanta ose nuk u bindej ose i sulmonte autoritetet osmane<sup>15</sup>.

### **Cilët ishin organizatorët dhe si lindi ideja për fillimin e kësaj kryengritjeje?**

Organizimi i Kryengritjes shqiptare të vitit 1912 kaloi në tri etapa kryesore: Etapa e parë, ishte periudha e përpunimit të idesë për kryengritje në mesin e elitës politike shqiptare, e cila u zhvillua në periudhën nga vjeshta e vitit 1911 deri në prill të vitit 1912; Etapa e dytë, lidhej me përhapjen e idesë kryengritëse nga elita tek shtresat e ndryshme të popullsisë shqiptare, që u zhvillua nga prilli deri në qershor të vitit

<sup>12</sup> *Historia e Shqipërisë ...*, vëll. II, f. 467.

<sup>13</sup> *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. II, f. 465.

<sup>14</sup> “Haxhi Adil beu në Shqipëri edhe Kërkimet e shqipëtarëve”, në *Koha*, nr. 6-26, Korçë, 8 mars 1912, f. 3.

<sup>15</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-6-682, Raport i kolonelit a-h Pomianovski, drejtuar Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë austro-hungareze në Vjenë, Konstandinopojë, 14 maj 1912; *Historia e Shqipërisë ...*, vëll. II, f. 467- 468.

1912; Etapa e tretë, përfshinte zhvillimin e lëvizjes kryengritëse dhe paraqitjen e kërkesave në emër të gjithë shqiptarëve, e cila përfshiu harkun kohor nga muaji qershor deri në gusht të vitit 1912.

Lidhur me organizimin e Kryengritjes së vitit 1912, Sylejman Kylçe (Süleyman Külçe) ka mbrojtur idenë se shqiptarët nuk ishin organizatorët e Kryengritjes së vitit 1912, por ishte opozita turke, e cila i nxiti shqiptarët drejt kryengritjes. Sipas tij, princi Sabahudin, Dr. Riza Nuri dhe Riza Bej Gjakova (Kryeziu) ishin “tri kokat” që vendosën për të organizuar një kryengritje në Shqipëri që do të çonte në rrëzimin e qeverisë xhonturke për shkak të vendimit të Partisë “Bashkim e Përparim” për shpërndarjen e parlamentit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme<sup>16</sup>. Që ka patur raporte bashkëpunimi ndërmjet figurave politike shqiptare dhe opozitës turke, kjo nuk mund të vihet në dyshim. Por, ideja e kryengritjes shqiptare u shtrua për herë të parë nga Hasan Prishtina dhe Isa Boletini në gusht të vitit 1911 në Shkup<sup>17</sup>, e cila u përpunua më tej nga elita politike në Stamboll, gjatë muajve dhjetor 1911 - janar 1912. Njoftimi për shpalljen e zgjedhjeve të reja për në Parlamentin Osman u mor më vonë më 18 janar 1912 dhe ky akt vetëm sa nxiti më tepër idenë e fillimit të kryengritjes shqiptare. Përfundimet në të cilat ka arritur S. Kylçe është e qartë se lidhen më tepër me perceptimin e krijuar prej tij, thjesht duke e parë me dyshim bashkëpunimin që u përpoq të vendoste elita politike shqiptare me opozitën turke para dhe gjatë kryengritjes<sup>18</sup>.

Pas seancës parlamentare të datës 11 janar 1912, u zhvilluan dy takime ndërmjet Ismail Qemalit dhe Hasan Prishtinës me synim organizimin e një kryengritjeje të shqiptarëve kundër qeverisë xhonturke. Në këto takime, pasi u arrit në përfundimin se pas një lufte të ashpër trevjeçare të xhonturqve ndaj shqiptarëve, kryengritja e armatosur e shqiptarëve ishte e vetmja rrugë për sigurimin e të drejtave kombëtare të shqiptarëve. Për këta qëllim, u vendos që të organizohej një mbledhje e përbashkët e grupit të deputetëve shqiptarë në shtëpinë e Syrja Bej Vlorës në lagjen “Taksim” të Stambollit. Në mbledhjen e Taksimit që njihet si “Komploti i Taksimit”, ishin të pranishëm Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Myfid Bej Libohova, Esad Pashë Toptani, Aziz Pashë Vrioni,

<sup>16</sup> Süleyman Külçe, *Osmanlı Tarihinde Arnavutluk*, Izmir: 1944, f. 412.

<sup>17</sup> Fatmira Musaj, *Isa Boletini (1864-1916)*, Tiranë: “Mësonjëtorja”, 1987, f. 110.

<sup>18</sup> S. Külçe, *Osmanlı Tarihinde...*, f. 412.

Syrja Bej Vlora, Bedri Pejani dhe Mustafa Asimi (Kruja). Ky grup mori disa vendime të rëndësishme, për organizimin e një kryengritjeje shqiptare, të cilat janë gjerësisht të njohura<sup>19</sup>. Çështja më e rëndësishme që u diskutua në këtë takim ishte mënyra e organizimit të kryengritjes si dhe koha e fillimit të saj. Përzgjedhja e Kosovës si vend ku do të shpërthente kryengritja shqiptare, ishte një vendim i drejtë dhe racional. Së pari, popullsia shqiptare e Kosovës nga viti 1909 e deri në këtë periudhë kishte provuar më tepër se çdo krahinë tjetër, pasojat e ekspeditave ndëshkimore xhonturke. Së dyti, Kosova u përzgjedh për faktin se ishte një vend i përshtatshëm nga mund të realizohej furnizimi me armë i kryengritësve nga Mali i Zi. Së treti, Hasan Prishtina e kishte më të lehtë të hynte në lidhje me prijësit popullorë për organizimin e kryengritjes dhe se një pjesë e shqiptarëve nuk i kishte lëshuar armët nga dora. Së katërti, pjesëmarrësit e këtij takimi kishin bindjen se kryengritja do të gjente mbështetje tek shqiptarët e Kosovës pasi ndjenja e lirisë tek kjo popullsi, ishte kultivuar në luftën e gjatë për mbijetesë<sup>20</sup>.

Që në vështrimin e parë të vendimeve të Taksimit, duket se plani i organizimit të kryengritjes paraqiste dobësi. Disa prej problemeve të cilat u shfaqën gjatë zhvillimit të kryengritjes e patën zanafillën qysh nga mbledhja e Taksimit. Vendimet në këtë mbledhje u morën me nxitim dhe pa një analizë të ftohtë të situatës dhe faktorëve pozitivë e negativë që mund të ndikonin në ecurinë e kryengritjes. Vendimi për fillimin e kryengritjes nuk u shoqërua me një plan veprimi të detajuar<sup>21</sup>. Me sa duket, gjatë takimit nuk u analizua dhe nuk u paraqitën skenarët e mundshëm të ecurisë së kryengritjes nga ana e pjesëmarrësve. Hartimi i një plani të detajuar kishte rëndësi të dorës së parë aq më tepër kur pritej që organizatorët dhe kryengritja do të ndeshnin në vështirësi të brendshme dhe të jashtme. Nga momenti i parashtrimit të idesë së kryengritjes e deri në shpërthimin e saj nuk pati kohë të mjaftueshme që ajo të përpunohej më mirë nga organizatorët. Megjithëse një pjesë e deputetëve ishin treguar aktivë kundër fushatave mizore të ushtrisë

<sup>19</sup> H. Prishtina, *Nji shkurtim kujtimesh ...*, f. 10; Mihal Grameno, *Kryengritja shqiptare*, Vlorë: Shtypshkronja “G. Direttore”, 1925, f. 125-126; Ajet Haxhiu, *Hasan Prishtina dhe Lëvizja patriotike e Kosovës*, Tiranë: Naim Frashëri, 1968, f. 49.

<sup>20</sup> Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina në Lëvizjen Kombëtare e Demokratike Shqiptare (1908-1933)*, Prishtinë: “GME”, 2003, f. 100.

<sup>21</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-2-288, Raport i konsullit a-h Kral, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Selanik, 25 qershor 1912.

osmane në viset shqiptare, shumica e tyre ishin të shkëputur nga realiteti shqiptar por as nuk dëshironin të vinin në rrezik interesat e tyre. Pjesëmarrësit në këtë mbledhje e kishin të qartë se qëndrimi i Fuqive të Mëdha, ishte mjaft i rëndësishëm për organizimin dhe mbarëvajtjen e kryengritjes, por nuk ishin të sigurtë nëse do të arrinin të siguronin mbështetjen e tyre. Të gjitha këto mangësi të marra së bashku, ishin një indikacion i qartë që tregonte se zanafilla e mos suksesit të Kryengritjes së vitit 1912 filloi qysh nga mbledhja e Taksimit dhe se organizatorët e kryengritjes do ta kishin të vështirë të realizonin objektivat kombëtarë.

Plani i nismëtarëve të organizimit të kryengritjes u përqendrua në këto drejtime kryesore: sigurimin e mbështetjes së fuqive të interesuara për çështjen shqiptare; arritjen e bashkëpunimit me drejtues të lëvizjeve kombëtare arabe dhe maqedone me qëllim rritjen e forcës kryengritëse dhe dobësimin e forcës goditëse të ushtrisë osmane ndaj popullsisë shqiptare; krijimin e rrjetit të bashkëpunimit me drejtuesit e kolonive shqiptare jashtë atdheut si dhe me parinë shqiptare. Pavarësisht synimit të nacionalistëve shqiptarë, bashkëpunimi ndërmjet organizatave nacionaliste shqiptare dhe atyre bullgare nuk u arrit për shkak se qeveria bullgare e konsideronte të rrezikshme për interesat e saj përhapjen e kryengritjes shqiptare<sup>22</sup>.

Ndryshe nga sa pritej, Austro-Hungaria doli kundër kësaj kryengritjeje për disa arsye kryesore. Ekspertët austriakë mendonin se në këtë periudhë “ndjenja e unitetit kombëtar në viset shqiptare nuk kishte shkuar aq larg, sa të bëhej i mundur një aksion i përbashkët” i të gjithë shqiptarëve. Faktori kryesor negativ që ndikonte në këtë drejtim ishte se masa e gjerë e shqiptarëve nuk kishte arritur ndërgjegjen e duhur politike, si dhe grupimi i elitës politike shqiptare që kishte marrë përsipër drejtimin e popullit shqiptar ishte i paorganizuar nga pikëpamja politike. Diplomatët vjenezë kishin kuptuar se lëvizjet kryengritëse shqiptare kishin karakter lokalist dhe mbeteshin të izoluara. Ndërkaq, ekspertët ushtarakë austriakë kishin bindjen se kryengritja shqiptare do të shtypej me forcë, për shkak të epërsisë së madhe ushtarake osmane. Ata kishin të dhëna se Serbia dhe Bullgaria po punonin për krijimin e një aleance ushtarake ndërkohë që organizatorët e kryengritjes nuk ishin në dijeni të nënshkrimit të marrëveshjes bullgaro-serbe, më 13 mars 1912. Në këto

<sup>22</sup> Zekeria Cana, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë në vitet 1908-1912*, Prishtinë: “Rilindja”, 1979, f. 204-205.

rrethana, diplomacia austriake erdhi në përfundimin se zgjidhja e çështjes shqiptare “nuk arrihej me lëvizje të pafrytshme dhe të izoluar, si dhe në përpjekje të veçuara, por me përpjekje serioze për zgjerimin e kulturës popullore në kuptimin kombëtar, në mirëkuptimin kombëtar të gjitha viseve ndërmjet tyre dhe në forcimin ekonomik”<sup>23</sup>.

Qeveria italiane mbajti një qëndrim të papërcaktuar ndaj kryengritjes shqiptare. Diplomacia italiane nga njëra anë mendonte se Italia nuk duhej të mbështeste këtë kryengritje pasi ajo i druhej mundësisë së ndërhyrjes së Austro-Hungarisë dhe të shteteve ballkanike në trevat shqiptare<sup>24</sup>. Mirëpo, nga pikëpamja e interesave politike, qeverisë italiane i interesonte që t’i hapte probleme Perandorisë Osmane<sup>25</sup>, si dhe të rriste ndikimin e saj tek drejtuesit e nacionalizmit shqiptar. Në këto kushte, ajo vendosi që në pamje të parë të dilte kundër fillimit të kryengritjes, por nga ana tjetër, ajo nuk pengoi veprimtarinë e komiteteve “Pro Albania” që vepronin në favor të kryengritjes si dhe dërgonin armë në Shqipëri.

Ndryshe nga një vit më parë, kësaj here qëndrimet e dy shteteve fqinje veriore paraqisnin një tablo të ndryshme nga qëndrimi që mbajtën gjatë kryengritjes së vitit 1911. Qëndrimi i shteteve fqinje ndaj kryengritjes shqiptare u kushtëzua nga dy faktorë kryesorë që nuk përputheshin me njëri-tjetrin: së pari, ato ishin të interesuar që shqiptarët t’i jepnin një goditje të rëndë shtetit osman në mënyrë që atyre t’u mbetej vetëm për t’i dhënë atij shtyrjen e fundit; së dyti, drejtuesit e shteteve fqinje ishin mjaft të shqetësuar nga aspirata e shqiptarëve për shpalljen e autonomisë, por veçanërisht nga synimi i tyre për të përcaktuar kufijtë e tokave shqiptare. Qeveria e Malit të Zi mbajti një qëndrim të rezervuar ndaj përpjekjeve të shqiptarëve për organizimin e kryengritjes<sup>26</sup>. Nën trysninë e Austro-Hungarisë dhe këshillat e qeverisë ruse, ajo vendosi kësaj here të mbante qëndrim “paqësor” kundrejt kryengritjes shqiptare, si dhe të refuzonte plotësimin e kërkesave të shqiptarëve për armë<sup>27</sup>, por

<sup>23</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-2-235; Vj. 22-18-1833, Raport i konsullit austro-hungarez Kral, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Selanik, 5 janar 1912.

<sup>24</sup> *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, hartuar nga Aleks Buda, Kristo Frashëri, Stefanaq Pollo, Jusuf Alibali, Ndreçi Plasari, Botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1965, f. 328-329.

<sup>25</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-2-212, Relacion i ministrit Fuqiplotë austro-hungarez Ugron, drejtuar kontit Aehrenthal, Beograd, 5 janar 1912.

<sup>26</sup> *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. II, f. 463.

<sup>27</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe*, përgatitur nga Zekeria Cana, Prishtinë: “KGT”, 2008, dok. 75, f. 124; HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-6-630,

Mali i Zi mbylli sytë ndaj dhënies së armëve për disa krerë shqiptarë. Qeveria serbe hyri në lidhje dhe u përpoq t'i bënte për vete krerët e lëvizjes shqiptare në Kosovë, kryesisht duke i furnizuar me armë, me qëllim që t'i nxiste kundër shtetit osman dhe të përgatiste terrenin e përshtatshëm për pushtimin e këtyre krahinave. Ajo planifikonte që ta orientonte kryengritjen në drejtimin e dëshiruar prej saj, ta shkëpuste nga kërkesa për autonomi politike dhe nga ndikimi austro-hungarez e malazez dhe të përfitonte sa më tepër prej saj kur të dobësoheshin të dy palët<sup>28</sup>.

Për shkak të situatës së vështirë që u krijua për shumicën e shqiptarëve, fillimi i kryengritjes kundër qeverisë xhonturke ishte i pashmangshëm. Mirëpo, mungesa e mbështetjes së jashtme për kryengritësit shqiptarë, shtronte para organizatorëve të kryengritjes dy probleme kryesore: Së pari, a i kishin shqiptarët mundësitë e duhura për të zhvilluar të vetëm kryengritjen? Së dyti, a rrezikonte kryengritja të shkonte në hullinë e interesave të shteteve fqinje, veçanërisht atyre sllave të cilat qysh prej vitit 1909 ishin të gatshme të godisnin Perandorinë Osmane? Këto dy çështje ishin të rëndësishme dhe mjaft të lidhura me njëra-tjetrën. Mungesa e armëve dhe e mjeteve financiare ishin faktorë të rëndësishëm që ndikuan në ecurinë dhe rezultatet e kësaj kryengritjeje nga fillimi deri në fund të saj. Zanafilla e këtij problemi duhet të kërkohet tek vendimet që morën në Taksim, krerët shqiptarë. Në këndvështrimin tonë, nuk është e qartë se si ishte i mundur të merrej përsipër me kaq siguri zotimi për sigurimin dhe transportimin e armëve dhe të mjeteve financiare, kur dihej se sipërmarrje të kësaj natyre nuk ishin të lehta. Mbledhja e Taksimit, gjithashtu nuk i kishte dhënë përgjigje pyetjes se nëse armatimi dhe mjetet financiare nuk arrihej të siguroheshin, si do të veprimej nga ana e organizatorëve të kryengritjes.

### **Fillimi i Kryengritjes Shqiptare të vitit 1912 dhe problemet e shfaqura**

Data e saktë e fillimit të Kryengritjes Shqiptare të vitit 1912 është vështirë të përcaktohet sepse veprimet kryengritëse ishin të paorganizuara, sporadike dhe të palidhura me njëra-tjetrën. Veprimet

Telegram i kontit Berchtold, ministër i Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, drejtuar diplomatit Kolossa në ambasadën e Stambollit, Vjenë, 11 qershor 1912.

<sup>28</sup> *Historia e Shqipërisë ...*, Tiranë: 1984, f. 468; Z. Cana, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare ...*, f. 210-211.

kryengritëse të shqiptarëve filluan qysh në muajt janar - shkurt 1912 në rrethinat e Gjakovës dhe të Pejës, nga çetat e Mahmut Zajmit dhe Zefit të Vogël, të cilat i shkaktuan humbje forcave osmane<sup>29</sup>. Gjatë muajve mars-prill forcat kryengritëse ndërmorën disa aksione më të ashpra kundër trupave osmane në Gjakovë, Has, Rekë dhe Pejë. Nga mesi i muajit prill 1912, përleshjet e armatosura me forcat osmane filluan të bëheshin gjithnjë e më të shpeshta në Malësinë e Gjakovës, ndërkohë që në muajin maj 1912, krahas vatrave të mëparshme, kryengritja shpërtheu edhe në krahinat e Llapit, Shalës, Lumës, Mirditës, Bregut të Matit dhe Zadrimës<sup>30</sup>.

Në mbledhjen e Taksimit nuk ishte përcaktuar as qëndrimi që do të mbanin shqiptarët ndaj procesit të zgjedhjeve për në Parlamentin Osman: do të hynin shqiptarët në zgjedhje apo do ta braktisnin fushatën zgjedhore. Mirëpo, sapo erdhën në Shqipëri, nismëtarët e kryengritjes u morën më tepër me çështjen e zgjedhjes së tyre për deputetë në Parlamentin Osman dhe "harruan" mbledhjen e Taksimit<sup>31</sup>. Me sa duket, në këmbim të mbështetjes së Myfid Bej Libohovës për kandidatin e krishterë Vasilios Desriris në viset jugore si dhe dorëheqjes së tij nga ideja e kryengritjes në krahinën e Gjirokastrës, ai siguroi mbështetjen e patrikut ortodoks grek dhe të konsullatave greke në Janinë e Gjirokastrë, që t'i lehtësohej nga qeveria greke procesi i shitjes së pasurisë që M. Libohova kishte në Thesali<sup>32</sup>. Ismail Qemali, dhe Luigj Gurakuqi ende nuk kishin shkuar në vendet evropiane për të siguruar armë dhe ndihma të tjera për kryengritjen. Në këto rrethana të vështira, pa peshuar si duhet faktorët, të cilët do të ndikonin në kryengritje, Hasan Prishtina pasi shiti magazinat e tij, vendosi t'u bënte thirrje shqiptarëve të Kosovës që të hidheshin në kryengritje<sup>33</sup>.

Megjithëse ishte marrë vendimi për fillimin e kryengritjes, deri në fund të muajit maj, forcat nacionaliste nuk arritën të kishin një qendër të

<sup>29</sup> Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare (1911-1912)*, Libri 2, Prishtinë: "KGT", 2004, f. 201; *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe ...*, f. 12-15.

<sup>30</sup> *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. II, f. 478.

<sup>31</sup> T. Abdyli, *Hasan Prishtina në Lëvizjen Kombëtare ...*, f. 102-103.

<sup>32</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-21-2143, Letër e konsullit austro-hungarez, Bilinski, drejtuar kontit Berchtold në Vjenë, Janinë, 15 qershor 1912.

<sup>33</sup> H. Prishtina, *Nji shkurtim kujtimesh ...*, f. 21.

vetme drejtuese<sup>34</sup>. Në mesin e një pjese të mirë të shqiptarëve me në krye Abdyl Bej Ypi u krijua një rrymë tjetër mendimi që ishte për një lidhje të ngushtë e të sinqertë bashkëpunimi të shqiptarëve me partinë xhonturke, derisa kjo të jetë në përputhje me interesat e tyre kulturore e kombëtare. Kjo lidhje sipas tij, shërbente për të siguruar përfitime sa më të mëdha për kombin shqiptar<sup>35</sup>. Gazeta “Liri e Shqipërisë” përmes artikullit “Si punuam, si punojmë dhe duam të punojmë” dënonte përçarjen dhe mungesën e bashkimit ndër shqiptarë. Ajo arrinte në përfundimin se “duhet krijuar një qendër, e cila të lidhë Shqipërinë dhe vetëm ajo qendër të urdhërojë ku të përpiqen; ajo qendër t’u apë lejë për të folur; ajo qendër të vërë kërkimet, dhe jo siç bëjmë gjer më sot, çdo kryengritje të ketë kërkimet e saj... ca kërkojnë privilegje, ca kërkojnë të mos paguajnë taksa, ca kërkojnë reforma ... ca kërkojnë të vërtetin kërkim, autonominë”<sup>36</sup>.

Krahas vështirësive, pati edhe faktorë që shkuan në favor të organizimit të kryengritjes. Tek shumica e shqiptarëve mbizotëronte një urrejtje e madhe ndaj xhonturqve. Hasan Prishtina nxiti më tepër idenë e kryengritjes tek prijësit popullorë shqiptarë, pas së cilëve qëndronin me qindra mbështetës të armatosur. Prandaj, mbështetja e parisë vendase shkoi në dobi të organizatorëve në fazën fillestare të mobilizimit të shqiptarëve për kryengritje<sup>37</sup>. Falë bashkëpunimit me krerët lokalë shqiptarë, drejtuesit e kryengritësve siguruan mbështetjen në burimet e popullsisë së krahinave ku shpërtheu kryengritja. Faktor tjetër i rëndësishëm që ndikoi në mobilizimin e shqiptarëve për t’u hedhur në kryengritje ishin masat e rrepta administrative dhe policore që u përdorën gjatë fushatës zgjedhore nga xhonturqit si dhe fakti që në Parlamentin e ri Osman nuk u zgjodhën deputetët shqiptarë të opozitës të cilët kishin influencë në vend. Ky faktor ndihmoi në zgjerimin e radhëve të atyre që ishin të gatshëm të rrëmbenin armët. Pas humbjes së ish deputetit Basri

<sup>34</sup> *AQSH*, F. 97, V. 1912, D. 58, fl. 12, Letër e Ismail Qemalit, Luigj Gurakuqit dhe Fazil Toptanit drejtuar Pleqësisë së Shoqërisë Shqiptare “Vëllazëria” në Egjipt, Nicë, 25 maj 1912.

<sup>35</sup> *HHStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-19-1946; Vj. 22-17-1750, Raport i konsullit Halla, drejtuar kontit Aehrenthal në Vjenë, Manastir, 17 shkurt 1912.

<sup>36</sup> “Si punuam, si punojmë dhe duam të punojmë”, në *Liri e Shqipërisë*, nr. 41, Sofje, 9 maj 1912, f. 1.

<sup>37</sup> *HHStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-17-1757, Telegram i konsullit a-h Halla, drejtuar ambasadorit Pallavicini në Stamboll, Manastir, 27 maj 1912.

Beu në zgjedhjet parlamentare, ai u vu në krye të kryengritësve shqiptarë kundër trupave osmane në krahinën e Dibrës. Basri Beu hyri në lidhje me drejtuesit e kryengritjes së Kosovës. Ai vendosi të shkonte në Kthellë të Mirditës dhe atje lidhi “Besën” me banorët e asaj zone si dhe me një pjesë matjanësh. Synimi ishte që në rrethana të caktuara banorët myslimanë dhe katolikë të Kthellës të bllokonin lëvizjen e trupave osmane në rrugën që lidhte Tiranën me Kurbinin<sup>38</sup>.

Shtrohet pyetja përse autoritetet osmane nuk i dhanë një goditje të fortë dhe përfundimtare kryengritjes së shqiptarëve që në zanafillë të saj? Qëndrimi i tërhequr ndaj kryengritjes shqiptare lidhej kryesisht me pikëpamjet e ndryshme që ekzistonin brenda radhëve të Partisë “Bashkim e Përparim”<sup>39</sup>. Në rrethet ushtarake, kishte një grupim njerëzish me në krye Ferik Zeki Pasha e Masar Beu, drejtuesit xhonturq të Shkupit, të cilët ishin të mendimit se çështja shqiptare duhej të zgjidhej përmes një aksioni energjik ushtarak kundër kryengritësve shqiptarë. Ky qëndrim përcaktohej nga fakti se qysh në këtë periudhë tek një pjesë e kryengritësve viheshin re shenja të lodhjes dhe të pendimit si dhe numri i kryengritësve shqiptarë nuk ishte aq sa raportohej<sup>40</sup>. Ndërkohë, në mesin e xhonturqve ekzistonte edhe një grupim tjetër me në krye ministrin e Brendshëm Haxhi Adil Beu, i cili mbronte idenë se qeveria osmane duhet të kishte një qasje tjetër me shqiptarët. Sipas mendimit të këtij grupimi, autoritetet osmane duhej të shmangnin një veprim agresiv, të paktën në fillim ndaj kryengritësve shqiptarë të Pejës dhe të Gjakovës. Ai arriti në këtë përfundim gjatë vizitës së tij në viset shqiptare ku kishte konstatuar nga njëra anë mungesën e organizimit dhe të bashkëpunimit midis çetave dhe të komiteteve shqiptare, nga ana tjetër, kishte vënë re se përfaqësuesit e banorëve të krahinave të ndryshme, i paraqitën atij kërkesa me karakter të ndryshëm<sup>41</sup>.

<sup>38</sup> *Po aty*, Vj. 22-15-1586, Telegram i Franz Kolossa, këshilltar i Legatës a-h në Stamboll, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Tiranë-Durrës, 31 maj 1912.

<sup>39</sup> *Po aty*, Vj. 22-5-591, Informacion i konsullit a-h Kral, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Selanik, 24 maj 1912.

<sup>40</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 ...*, dok. 161, f. 225.

<sup>41</sup> HHSStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-5-591, Informacion tepër konfidencial i konsullit a-h Kral drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Berchtold, Selanik, 24 maj 1912.

### **Vendimet e Kuvendit të Junikut maj 1912, një përqsasje krahasuese me vendimet e Kuvendit të Greçës të vitit 1911**

Pas rrethimit të qytetit të Gjakovës nga forcat kryengritëse shqiptare, kajmekami i këtij qyteti, arriti të shmangë sulmin e tyre, pasi u premtoi kryengritësve se brenda 15 ditëve do të merrte një përgjigje pozitive nga Stambolli për kërkesat e tyre. Në pritje të përgjigjes, kryengritësit e Malësisë së Gjakovës, të Hasit, të Krasniqes, të Gashit dhe të Rekës u mblodhën në Krasniqe më 21 prill 1912, në vendin e quajtur me emrin “Kuvendi i katër bajraqeve”. Kuvendi miratoi një memorandum me disa kërkesa, si: kthimin e armëve, shërbimin ushtarak në vend, çeljen e shkollave shqipe, liri për mësimin e gjuhës shqipe me alfabet latin, ngritjen e flamurit kombëtar, nëpunësit të njihnin gjuhën shqipe, shpalljen e një amnistie të përgjithshme, të paguheshin dëmshpërblimet e tjera<sup>42</sup>.

Me synimin që shqiptarët të bashkoheshin me një besë të përbashkët kundër regjimit xhonturk, Hasan Prishtina u bë frymëzuesi i mbajtjes së Kuvendit të Junikut. Ky kuvend i zhvilloi punimet nga data 21 deri më 25 maj 1912 dhe në të morën pjesë delegatë nga vise të ndryshme të vilajetit të Kosovës si nga Peja, Istogu, Gjakova, Hasi, Malësia e Gjakovës, Fushë-Kosova, Vuçiterni dhe nga sanxhakët e Dibrës dhe të Shkodrës. Në krye të kuvendit qëndronin figura të rëndësishme kombëtare, si Hasan Prishtina, Nexhip Draga, por edhe figura popullore, si Xhemal Agushi, Zejnullah Vuçiterni, Sadik Rama, Bajram Curri, Isa Boletini, Riza Bej Gjakova, Rexhë Bajraktari, Jahja Agë (Doda) Prizreni, Islam Spahiu, Hasan Ferri, Mahmut Zajmi, Zefi i Vogël e të tjerë<sup>43</sup>. Kjo përbërje nxjerr në dukje dy aspekte të rëndësishme: së pari, në të nuk morën pjesë ideatorët e kryengritjes së mbledhjes së Taksimit; dhe së dyti, mungesa e përfaqësuesve të nacionalizmit shqiptar nga viset e tjera shqiptare

<sup>42</sup> *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1878 – 1912), (Memorandume, vendime, protesta, thirrje)*, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë: 1978, dok. 149, f. 233, Raport serbo-kroatisht i konsullit serb të Prishtinës, drejtuar Beogradit, 19 prill / 2 maj 1912.

<sup>43</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 ...*, dok. 172/188, f. 240, 256; *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. II, f. 463.

dëshmonte se rrethet patriotike shqiptare ishin ende të dobëta dhe të paorganizuara. Edhe kësaj here, elita e nacionalizmit shqiptar e pati të vështirë që të shkëputej nga diskursi propagandistik dhe të vihej në krye të lëvizjes kryengritëse.

Me nxitjen e Hasan Prishtinës, figura të njohura, si Bajram Curri, Riza Bej Gjakova, Jahja Agë (Doda) Prizreni, Ahmet Beu, Hysni Curri e të tjerë që ishin dërguar në Junik me qëllim “pajtimi”, u bashkuan me forcat kryengritëse<sup>44</sup>. Në mesin e pjesëmarrësve në këtë kuvend u shfaqën dy rryma kryesore mendimi: rryma e parë, përbëhej nga Hasan Prishtina, Isa Boletini, Riza Bej Gjakova, Jashar Pasha dhe Hasan Ferri, e cila mbronte mendimin se qeveria xhonturke nuk u kishte lënë rrugë tjetër shqiptarëve veçse të hidheshin në kryengritje të përgjithshme kundër saj për shpalljen e autonomisë. Shtabi i kryengritjes me në krye Hasan Prishtinën mendonin se fillimisht kryengritësit duhej të sulmonin Gjakovën. Më pas, ata duhej të merrnin Carralevën dhe Kaçanikun me perspektivën që ajo të përhapej edhe në pjesën tjetër të trojeve shqiptare<sup>45</sup>.

Çështjet e parashtruara në kuvend nga grupi i Hasan Prishtinës nuk gjetën pëlqimin e të gjithë pjesëmarrësve. Në mesin e një pjese të mirë pjesëmarrësish u konturuan rryma të tjera mendimi. Një pjesë e tyre, si kajmekami i Pejës Sejfedini, Zenel Bej Begolli, Jashar Pasha dhe Sulejman Agë Botusha që ishin mbështetës të xhonturqve, dolën kundër kryengritjes. Ata synonin të bindnin delegatët shqiptarë që të hiqnin dorë nga ideja e kryengritjes kundër qeverisë, pasi kjo e fundit do të merrte parasysh kërkesat për mësimin e gjuhës shqipe në shkolla dhe kryerjen e shërbimit ushtarak në viset shqiptare<sup>46</sup>. Në mesin e pjesëmarrësve, gjendej edhe një pjesë tjetër e parisë shqiptare të Kosovës, e drejtuar nga paria e Prishtinës me në krye Xhemal Agushin, e cila ishte bashkuar me grupimin e itilafistëve dhe luftonte për rrëzimin e qeverisë xhonturke;

<sup>44</sup> Niko Koleci, *Kryengritja e Përgjithëshme Shqiptare kundër sundimit turk në vitin 1912*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, 1962, f. 54; R. Abdyl, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare ...*, Libri 2, f. 239.

<sup>45</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-5-581, Telegram i konsullit a-h Prochaska, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Prizren, 22 maj 1912.

<sup>46</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 ...*, dok. 172, f. 240; HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-6-632, Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, drejtuar konsullit a-h Von Zambaur në Shkodër, Vjenë, 13 qershor 1912; “Me ç’farë kondita do të pajtohet guvernata turke”, në *Liri e Shqipërisë*, nr. 43, Sofje, 31 maj 1912, f. 3.

shpërndarjen e parlamentit dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja. Megjithëse, kjo rrymë ishte për përmbysjen e qeverisë xhonturke, njëkohësisht ajo ishte kundër shpalljes së autonomisë nga ana e shqiptarëve, pasi sipas tyre ky akt shkonte kundër interesave të shqiptarëve. Interesi i përbashkët për të përmbysur qeverinë xhonturke e bashkoi përkohësisht këtë rrymë me rrymën autonomiste<sup>47</sup>.

Kuvendi i Junikut mori vendime të cilat synonin njohjen e autonomisë së shqiptarëve në kuadër të Perandorisë Osmane. Kërkesat që dolën nga ky kuvend ishin vazhdim i kërkesave të artikuluar në Memorandumin e Greçës. Në Kuvendin e Junikut, u arrit bashkimi i një pjese të mirë të forcave shqiptare rreth një programi të përbashkët<sup>48</sup>. Për të analizuar mënyrën e zhvillimit të mendimit politik kombëtar të shqiptarëve, me interes është vendosja në plan krahasues i përmbajtjes së kërkesave të parashtruara nga Kuvendi i Junikut<sup>49</sup> me Memorandumin e Greçës. Duke patur përballë njëra-tjetrës, kërkesat e parashtruara nga kryengritësit shqiptarë në Kuvendin e Junikut me ato të paraqitura në Memorandumin e Greçës arrijmë në këto përfundime:

*Së pari*, në të dy dokumentet ka një numër të barabartë prej 12 kërkesash të parashtruara nga kryengritësit shqiptarë, por brenda secilës pikë të Memorandumit të Greçës ishin trupëzuar edhe kërkesa të tjera të formuluar si pika të vetme. Përmbajtja e të dy dokumenteve, dëshmon se kërkesat e shqiptarëve kishin në thelb synimin e rregullimit veçmas të jetës kombëtare të shqiptarëve.

*Së dyti*, në të dy dokumentet shqiptare, kërkesat paraqiteshin në emër të të gjithë shqiptarëve. Ato kishin përgjithësisht të njëjtin frymë dhe të njëjtin kuptim si dhe janë paraqitur përgjithësisht me të njëjtin numër rendor. Ndër kërkesat e përbashkëta që pasqyrohen pothuajse njësoj në të

<sup>47</sup> *Historia e Shqipërisë ...*, vëll. II, Tiranë: 1965, f. 331.

<sup>48</sup> N. Koleci, *Kryengritja e Përgjithëshme ...*, f. 53.

<sup>49</sup> *Akte të Rilindjes Kombëtare ...*, dok. 151, f. 234-235, "Memorandum i kërkesave që dolën nga pjesëmarrësit në Kuvendin e Junikut, Variant që i referohet gazetës *Koha*, Korçë, 27 qershor / 10 korrik 1912, e cila shkruan se e ka marrë nga gazeta *Neue Freie Presse* e Vjenës; Nevila Nika, *Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjet shqiptare (1910-1912)*, Botim i Institutit të Historisë së Prishtinës, Prishtinë: "KGT", 2003, dok. 137, f. 223, "Memorandum dërguar Portës së Lartë dhe Fuqive të Mëdha nga Kuvendi i shqiptarëve i mbledhur në Junik për t'ia njohur Shqipërisë të drejtat e një province autonome", [Junik, 21-25 maj 1912]; *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe ...*, dok. 249, f. 348 [Në këtë dokument përmendet si memorandum i tretë shqiptar i botuar në gazetën vjeneze "Neue Freie Presse"].

dy memorandumet janë: 1. Dhënia e garancisë shqiptarëve nga qeveria qendrore dhe autoritetet vendore se kurrë nuk do të përsëriteshin veprime që ishin në kundërshtim me kushtetutën osmane; 2. Njohja e ekzistencës së kombit shqiptar; 3. Liri të plotë për shqiptarët që të zgjidhnin deputetët e tyre sipas numrit të popullsisë; 4. Liri të plotë për shqiptarët që të mësonin e të përparonin në gjuhën shqipe; 5. Organizimi i administrimit të vilajeteve në të cilat jetonin shqiptarët, t'u përgjigjej nevojave të vendit dhe zakoneve të vendasve; 6. Valinjtë dhe nëpunësit e lartë të shtetit që shërbenin në vilajetet e banuara nga shqiptarë të zgjidheshin prej njerëzve më të mirë nga ata që njihnin gjuhën dhe zakonet e vendit; 7. Emërimi i një përfaqësuesi të sulltanit me detyrën e guvernatorit të përgjithshëm; 8. Gjuha shqipe të ishte gjuha zyrtare e administratës publike; 9. Shqiptarët duhej të kryenin shërbimin ushtarak në kohë paqeje në vendin e tyre, ndërsa në kohë lufte, atje ku kishte nevojë shteti osman; 10. Një pjesë e të ardhurave të mbledhura nga taksat e popullsisë vendase duhej të shpenzoheshin për nevojat e vendit, si: ndërtimi i shkollave, rrugëve, hekurudhave dhe për nevoja të tjera të popullsisë; 11. Këshillat e përgjithshme të vilajeteve duhej të merrnin vendime për rregullimin e buxhetit dhe të kontrollonin shpenzimet e kryera nga administrata; 12. Caktimi i një fondi të veçantë financiar, i cili të përdorej për ndërtimin e shtëpive të shqiptarëve që u ishin prishur apo djegur nga lufta.

*Së treti*, formulimi i pikave të programit të Junikut drejtuar qeverisë osmane është realizuar në mënyrë më sintetike, me një gjuhë më të qartë dhe më të drejtpërdrejtë krahasuar me tekstin e Memorandumit të Greçës. Kjo dëshmon se niveli politik i elitës kombëtare shqiptare ishte në rritje dhe nga ana tjetër ajo tregonte se shqiptarët ishin të vendosur në realizimin e kërkesave të tyre politike. Përmbajtja pothuajse e njëjtë e kërkesave dëshmon se nacionalistët shqiptarë kishin përpunuar në vija kryesore platformën e tyre kombëtare, tërësia e kërkesave të parashtruara prej tyre, çonte në realizimin e autonomisë së shqiptarëve në kuadër të Perandorisë Osmane. Megjithatë, duhet theksuar se edhe në këto dokumente kërkesa për autonomi dhe ajo e një vilajeti të përbashkët shqiptar nuk ishte formuluar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Është e qartë se zbatimi në praktikë i këtyre kërkesave çonte në njohjen e shqiptarëve si komb i veçantë, krijimin e një njësie administrative autonome shqiptare me kufij të përcaktuar, si hapa të rëndësishëm drejt rrugës së pavarësisë. Kërkesat e qarta të shprehura në këto dy memorandume shënojnë pikën

më kulmore të ndërgjegjësimit kombëtar të shqiptarëve pak para shkëputjes së tyre nga Perandoria Osmane.

Ndërmjet kërkesave që gjenden në njërin dokument ka disa pika, të cilat nuk gjenden ose ndryshojnë në krahasim me tekstin e dokumentit tjetër. Në kërkesat e parashtruara nga Kuvendi i Junikut, që në pikën e parë të tij kërkohej në mënyrë të përmbledhur dhe të qartë njohja e kombit shqiptar pa marrë si pikë referimi kombet e tjera të Perandorisë Osmane, ndërsa në Memorandumin e Greçës kërkohej që shqiptarët të gëzonin të drejta të njëjta kombëtare që kishin kombet e tjera të Perandorisë Osmane. Në dokumentin e Junikut parashtrohej kërkesa që gjuha shqipe të kishte një pozitë të barabartë me gjuhën turke, ndërkohë në Memorandumin e Greçës kërkohej në mënyrë më të qartë që shqiptarët duhej të mësonin në gjuhën shqipe si në shkolla të veçanta edhe në shkolla publike. Në kërkesat e Junikut kërkohej në mënyrë të qartë, caktimi i një guvernatori të përgjithshëm, ndërsa në Memorandumin e Greçës kërkohej emërimi nga sulltani i një inspektori të përgjithshëm për koordinimin e veprimtarisë së valinjve. Gjithashtu, Memorandumi i Greçës përmbante disa kërkesa, të cilat nuk gjenden në dokumentin e Junikut, si: autoritetet osmane duhej të njihnin të drejtat që u ishin njohur më parë krerëve të besimit të krishterë për sa i përket mësimin në shkollat që ishin nën autoritetin e tyre; kthimin e armëve të mbledhura nga shqiptarët por me kushtin që shqiptarët pas këtij akti t'i nënshtroheshin një ligji të posaçëm; dhe njohjen e së drejtës së malësorëve për prerjen e druve në pyjet e vendit.

### **Faktorët që çuan në zgjerimin e Kryengritjes Shqiptare**

Kryengritja Shqiptare nuk arriti të zgjerohet në përpjestime të mëdha deri në fund të muajit qershor të vitit 1912. Shkaku kryesor ishte rënia e moralit në mesin e kryengritjes pas disfatës që pësuan në Pejë më 6 qershor 1912 dhe tërheqjen e tyre nga ky qytet<sup>50</sup>. Në mesin e kryengritësve u krijuan dy rryma mendimi: e para, e përbërë nga bejlerët e Vushtrisë, Prizrenit dhe Gjakovës, Hasan Prishtina, Isa Boletini, Mahmut Zajmi, Bajram Curri dhe Hasan Ferri, shprehej se kryengritja duhej të vazhdonte pasi të arrihej një marrëveshje e plotë ndërmjet grupeve të ndryshme shqiptare; e dyta, e drejtuar nga bejlerët e Pejës,

<sup>50</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe ...*, dok. 210, f. 294.

Sadik Rama, Ramadan Shabani mendonte se kryengritja nuk duhej të vazhdohej më tej pasi ajo kishte dështuar për këtë vit, prandaj ata u kthyen në shtëpitë e tyre. Mbështetësit e këtij mendimi shpreheshin se meqenëse kryengritja ishte përgatitur jashtë atdheut, ajo rezultoi e papërgatitur dhe e dobët në terren. Ajo shfaqti dobësi pasi ishte nën ndikimin e huaj dhe kryengritësit kishin shumë pak armë<sup>51</sup>. Disfata e pësuar në Pejë nxiti mosmarrëveshjet ndërmjet drejtuesve të kryengritjes, pasi tek ata u shtrua çështja se “cilit shtet duhej t’u binin në dorë për t’u çliruar nga xhonturqit?”<sup>52</sup>. Pikërisht, kjo çështje ndikoi gjatë gjithë kryengritjes, por veçanërisht në etapën finale të saj, pasi grupet kryesore të udhëheqjes së kryengritjes pengonin njëri-tjetrin me dyshimin se në rast të shëmbjes së Perandorisë Osmane, njëri krah kërkonte t’i hapte rrugë Austro-Hungarisë në viset shqiptare dhe tjetri dyshonte se krahu tjetër kërkonte t’i hapte shtegun Serbisë e Malit të Zi në Kosovë<sup>53</sup>.

Pas mbledhjes së Junikut, lëvizja kryengritëse e popullsisë shqiptare mori një vrull më të madh. Kryengritja shënoi një kthesë të rëndësishme pas fitores së forcave kryengritëse të drejtuara nga Bajram Curri në betejën e Qafës së Prushit në fillim të muajit qershor 1912. Forcat osmane u thyen dhe lanë në fushën e betejës rreth 300 të vrarë si dhe mjaft armë e municione luftarake<sup>54</sup>. Kjo fitore entuziazmoi forcat kryengritëse në të gjithë Kosovën dhe ndikoi në ecurinë e kryengritjes. Në lidhje me të, Hasan Prishtina do të shkruante se “kjo fitore e gjallëroi kryengritjen në Kosovë”<sup>55</sup>. Më 30 korrik forcat kryengritëse të drejtuara nga Riza Bej Gjakova, Bajram Curri dhe Mahmut Zajmi hynë në Gjakovë. Garnizoni ushtarak osman atje u dorëzua dhe 78 oficerë i telegrafuan Portës së Lartë se nuk do të luftonin kundër shqiptarëve<sup>56</sup>. Kryengritësit shqiptarë zhvillonin luftime të pandërprera me forcat osmane në Podujevë, Prishtinë dhe në Rrafshin e Dukagjinit.

Një pjesë e studiuesve shqiptarë, me të drejtë kanë arritur në përfundimin se kryengritja u zgjerua më tepër aty nga fundi i muajit

<sup>51</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe ...*, dok. 212, f. 296; dok. 260, f. 359.

<sup>52</sup> *Po aty*, dok. 215, f. 303.

<sup>53</sup> *Po aty*, dok. 297, f. 401; dok. 302, f. 405.

<sup>54</sup> *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. II, f. 472.

<sup>55</sup> *Historia e Shqipërisë ...*, Tiranë: 1965, f. 332-334.

<sup>56</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe ...*, dok.280, f. 380; dok. 282, f. 383.

qershor. Ajo përputhet edhe me deklaratën e Salih Gjukës i cili kishte pohuar se data 23 qershor ishte përcaktuar si kohë e fillimit në shkallë të gjerë të kryengritjes<sup>57</sup>. Më 27 qershor, rreth 20 mijë kryengritës nën drejtimin e udhëheqësve të tyre, pasi morën një rën pas tjetrës disa qytete të Kosovës marshuan drejt Prishtinës. Ata u mbledhën në Llap për t'u marrë vesh për fillimin e një aksioni të madh të përbashkët<sup>58</sup>. Në këtë takim, Hasan Prishtina, Riza Bej Gjakova e Isa Boletini u betuan se ata do të luftonin deri në fund kundër qeverisë xhonturke, derisa ajo t'ua plotësonte të gjitha kërkesat shqiptarëve. Konsulli serb në Prishtinë, M. Gj. Millojeviç shprehej se tashmë kryengritja shqiptare po merrte gjithnjë e më tepër karakter politik kombëtar<sup>59</sup>.

Një faktor i rëndësishëm që ndikoi në zgjerimin e kryengritjes ishte arrestimi në ditët e para të korrikut të mjaft familjeve të drejtuesve të kryengritësve, si të Bajram Currit, Mahmud Zajmit, Riza Bej Kryeziut, Ahmet Beut, Hysni Bej Currit, Jahja Agë Prizrenit, Sami Ishushës, Sadik Ramës, Isa Boletinit në Gjakovë, Pejë, Prizren, Vuçiternë, Prishtinë dhe Gjilan, të cilat u dërguan në formë internimi në Ferizaj e më pas në Shkup. Pengmarrja e familjarëve të kryengritësve ishte gabimi më i rëndë që bënë autoritetet xhonturke nga fillimi i kryengritjes e deri në këtë periudhë. Në vend që të ulnin vullmin e kryengritjes, "arrestimet patën efektin e hedhjes së benzinës në zjarr"<sup>60</sup>. Goditja ndaj familjeve të kryengritësve tregoi qartë dy anë të dobëta të politikës së ndjekur nga drejtuesit xhonturq. Së pari, ky akt i dëshpëruar dëshmoi se situata në Kosovë u kishte dalë jashtë kontrollit autoriteteve xhonturke. Së dyti, ajo vërtetoi edhe njëherë se xhonturqit të verbuar nga politika e tyre centraliste, nuk i njihnin mirë shqiptarët, doket, zakonet dhe mënyrën e jetesës së tyre. Përdorimi i pengmarrjes së familjeve si mjet presioni ndaj kryengritësve konsiderohej prej shqiptarëve si një akt i ulët, i cili shkonte kundër traditës zakonore të shqiptarëve por edhe kundër parimeve të besimit mysliman.

<sup>57</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-2-288, Raport i konsullit a-h Kral drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Selanik, 25 qershor 1912.

<sup>58</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe ...*, dok. 267, f. 367.

<sup>59</sup> *Po aty*, dok. 285, f. 386.

<sup>60</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-20-2094, Njoftim i nënkonsullit a-h Tahy drejtuar ambasadorit Pallavicini në Stamboll, Mitrovicë, 4 korrik 1912; Vj. 22-3-311, Telegram i konsullit a-h Prohaska drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Prizren, 4 korrik 1912.

Përhapja e kryengritjes shqiptare u nxit edhe për shkak të bashkëpunimit të drejtuesve të kryengritjes me një grup oficerësh si dhe një numër të konsiderueshëm ushtarësh shqiptarë të pakënaqur me drejtuesit e ushtrisë osmane. Bashkëpunimi mes dy palëve kishte nisur kohë më parë dhe erdhi gjithnjë duke u forcuar. Meqenëse “Lëvizja e Oficerëve Shpëtimtarë” synonte rrëzimin e qeverisë xhonturke, drejtuesit e kësaj lëvizjeje në vilajetin e Manastirit, vendosën të përkrahnin kryengritjen shqiptare<sup>61</sup>. Arratisja nga ushtria osmane dhe dalja në malet e Korçës e të Kolonjës e një grupi të përbërë nga 5 oficerë dhe rreth 150 ushtarë të drejtuar nga Tajar Bej Tetova i dha një goditje të rëndë qeverisë xhonturke<sup>62</sup>. Në javën e fundit të muajit qershor nga korpusi i VI i ushtrisë osmane, numri i të arratisurve në male ishte 25 oficerë dhe 339 deri në 469 ushtarë. Kundër bashkëpunimit me Lëvizjen e Oficerëve doli Dervish Bej Hima dhe Abdyl Bej Ypi<sup>63</sup>. Ismail Qemali i jepte dezertimit të batalionit të Manastirit, një karakter thjesht shqiptar, pasi prej disa muajsh, theksonte ai, në mesin e oficerëve shqiptarë po zhvillohej punë dhe një propagandë aktive<sup>64</sup>.

Bashkëpunimi i shqiptarëve me Lëvizjen e Oficerëve, kaloi në dy etapa. Në etapën e parë nga muaji shkurt deri në qershor, bashkëpunimi i shqiptarëve me Lëvizjen e Oficerëve të pakënaqur osmanë shkoi më tepër në favor të lëvizjes kryengritëse shqiptare. Kjo lëvizje ishte në interesin e shqiptarëve nëse mbahet parasysh përqëndrimi i madh i trupave osmane në Kosovë dhe vështirësitë e shumta që kishin të bënin me organizimin e kryengritjes në fillim të saj. Bashkëpunimi me Lëvizjen e Oficerëve dekurajoi përdorimin e forcës për të shtypur kryengritësit dhe jehona e kryengritjes u përhap nga Manastiri drejt viseve jugore. Vetë drejtuesit e qeverisë xhonturke pranonin se pas shfaqjes së trazirave në radhët e ushtrisë, kryengritja e shqiptarëve rrezikoi të merrte një karakter shqetësues<sup>65</sup>. Për të nxitur lëvizjen e oficerëve osmanë që të bashkë-

<sup>61</sup> Stavro Skëndi, *Zgjimi Kombëtar Shqiptar (1878–1912)*, përkthyer nga Skënder Luarasi dhe Nestor Nepravishta, Tiranë: Phoenix & Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2000, f. 424.

<sup>62</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-18-1822, Informacion i konsullit a-h Kral, drejtuar ambasadorit Pallavicini në Stamboll, Manastir, 23 qershor 1912.

<sup>63</sup> Po aty, Vj. 22-19-1957, Relacion i konsullit a-h Halla, drejtuar kontit Berchtold, Manastir, 9 mars 1912.

<sup>64</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe ...*, dok. 236, f. 333.

<sup>65</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-3-317, Njoftim i ambasadorit a-h Pallavicini në Stamboll, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Jenikoj, 5 korrik 1912.

punonin me shqiptarët, në fund të muajit qershor, në gazetën “Ikdam” që dilte në Selanik u botua një deklaratë e nënshkruar nga 19 udhëheqësit kryesorë të kryengritjes, mes të cilëve ishin Hasan Prishtina, Riza Bej Gjakova, Bajram Curri, Isa Boletini e të tjerë që shënonte një tërheqje të përkohshme nga platforma e miratuar në Junik<sup>66</sup>.

Në etapën e dytë, nga gjysma e dytë e korrikut deri në gusht të vitit 1912, bashkëpunimi i shqiptarëve me oficerët e pakënaqur shkoi më tepër në dobi të këtyre të fundit. Pas marrjes së Prishtinës nga kryengritësit, në kulmin e fitoreve të shqiptarëve dhe kur pozitat e tyre tashmë filluan të forcoheshin për shkak se në Kosovë nuk kishte mbetur asnjë forcë ushtarake osmane e organizuar, drejtuesit e kryengritjes nuk arritën që kërkesat në tërësi apo pjesën më thelbësore të tyre, t’i artikulonin në mënyrë të qartë tek drejtuesit e Lëvizjes së Oficerëve. Pjesëmarrja e Lidhjes së Oficerëve në kryengritjen shqiptare, pas 21 korrikut rrezikonte që të shkrinte kërkesat nacionaliste të shqiptarëve me aspiratat e përgjithshme osmane siç ndodhi në vitin 1908. Lëvizja e Oficerëve e zgjeroi hapësirën e veprimit, duke përpunuar mendimin e opinionit publik shqiptar, si dhe duke orientuar kryengritjen drejt platformës politike të hartuar prej tyre, e cila kishte parashtruar tri kërkesa kryesore: rrëzimin e qeverisë xhonturke, shpërndarjen e Parlamentit Osman, zhvillimin e zgjedhjeve të reja “që të kënaqnin të gjithë e të gjitha fetë”, amnisti të përgjithshme dhe gjykimin e ministrave kryesorë të kabinetit xhonturk<sup>67</sup>.

Para pak vitesh studiuesi Romeo Gurakuqi ka shfaqur mendimin se “emërtimi kryengritja e përgjithshme, do të duhet të ridimensionohet, të saktësohet, të vendoset në kontekstin e zhvillimeve konkrete të ngjarjeve të periudhës dhe të analizohet në të gjithë elementët e saj përbërës”<sup>68</sup>. Për këtë qëllim, fillimisht do të duhej të përcaktohen dy aspekte thelbësore të saj: *së pari*, në cilat treva shqiptare u shtri flaka e kryengritjes së vitit 1912? dhe *së dyti*, duhet të saktësohet qartë nëse kryengritja ishte një lëvizje e organizuar në trajtën e rrathëve koncentrikë me një qendër të përbashkët që përhapej nga Kosova drejt trevave të tjera shqiptare apo kudo kishte nga një vatër të vogël zjarri.

<sup>66</sup> *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. II, f. 477.

<sup>67</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-20-2030, Relacion i konsullit a-h, Heimroth drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkup, 19 korrik 1912.

<sup>68</sup> Romeo Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914*, Tiranë: “UET Press”, 2012, f. 361-362.

Kryengritja Shqiptare e vitit 1912 pati si epiqendër vilajetin e Kosovës por ajo u shoqërua me precipitim të situatës kryengritëse edhe në vise të tjera shqiptare, si në vilajetin e Manastirit, por edhe në atë të Janinës dhe të Shkodrës. Nga dokumentacioni arkivor del qartë se kryengritja ishte përhapur nga Presheva, Mitrovica e Gjilani në veri e deri në Korçë, Kolonjë dhe Çamëri në jug<sup>69</sup>. Intensiteti më i madh i veprimeve të Kryengritjes Shqiptare të vitit 1912 mbeti në viset e Kosovës<sup>70</sup>. Në gjysmën e dytë të qershorit drejtuesit e lëvizjes kryengritëse të Shqipërisë së Mesme si Abdi Toptani, Mustafa Kruja, Lef Nosi dhe Dedë Coku u përpoqën të hynin në kontakt me drejtuesit e kryengritjes së vilajetit të Kosovës. Me sa duket, shkak për ndërprerjen e bashkëpunimit të përfaqësuesve të Shqipërisë së Mesme me përfaqësuesit e kryengritjes së Kosovës u bë ndërhyrja e qeverisë malazeze tek agjentët e saj në Pejë<sup>71</sup>. Për rrjedhojë, me përjashtim të disa kontakteve të veçuara me drejtuesit e kryengritjes së Kosovës, veprimet kryengritëse në Shqipërinë e Mesme u kufizuan në marrjen e përkohshme të qytetit të Krujës nga forcat kryengritëse më 4 korrik dhe në luftimet për marrjen e Lezhës ditën tjetër. Popullsia e viseve shqiptare nga Bregu i Matit e deri në lumin Shkumbin ishin përfshirë nga një flakë kryengritëse, e cila mbeti e izoluar dhe nuk arriti të bashkohej me zjarrin e kryengritjes në Kosovë. Vonesa në mbledhjen e forcave kryengritëse shqiptare, armatimi i dobët dhe municioni i pamjaftueshëm, dëshmon se kryengritja në viset e Shqipërisë së Mesme nuk ishte përgatitur si duhet. Lëvizja kryengritëse në këtë pjesë të vendit u realizua kryesisht nën ndikimin e Abdi Bej Toptanit, i cili kishte pranuar kërkesat e programit të kryengritësve në Kosovë<sup>72</sup>. Kryengritja në Shqipërinë e Mesme nuk pati sukses për shkak të qëndrimit të tërhequr që mbajti një pjesë e bejlerëve të Tiranës, të cilët për shkak të dhunës së ushtruar nga ekspedita e Turgut Pashës në vitin

<sup>69</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-21-2160, Raport i konsullit a-h Bilinski, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Janinë, 2 mars 1912.

<sup>70</sup> Tajar Zavalani, *Histori e Shqipërisë*, Tiranë: "Phoenix", 1998, f. 218; Vasil Kondis, *Greqia dhe Shqipëria (1908-1914)*, përkthyer nga Agim I. Tartari, Tiranë: "Husi Boshi", 2007, f. 95.

<sup>71</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 ...*, dok. 109, f. 163.

<sup>72</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-1-104, Raport i konsullit a-h Pollanz, drejtuar ambasadorit Pallavicini në Stamboll, Tiranë-Durrës, 12 korrik 1912.

1910, ishin larguar nga Tirana, duke qëndruar vazhdimisht të qetë në çifligjet e tyre<sup>73</sup>.

Në viset jugore të vendit veprimtaria e çetave dhe aktivistëve kombëtarë u orientua kryesisht në trajtën e agjitacionit kundër propagandave të huaja dhe organeve të Komitetit Xhonturk<sup>74</sup>. Megjithëse nuk pati luftime të ashpra, rrethet kombëtare të viseve jugore, arritën t'i drejtonin sulltanit dhe Portës së Lartë dy dokumente me frymë autonomiste: “Memorandum mbi vendimin e marrë nga Kuvendi i Përgjithshëm i Krerëve të Shqipërisë së Jugut, në Sinjë të Beratit, më 10/23 korrik 1912 dhe memorandumin e “Krerëve të Komitetit Revolucionar të kazasë së Vlorës”, më 22 korrik / 4 gusht 1912. Përfaqësuesit e rretheve nacionaliste në jug të vendit mendonin se duke përhapur njoftime mbi shpërthimin e mundshëm të kryengritjes në këto vise, do të arrinin të trembnin qeverinë xhonturke dhe ta detyronin atë të bënte lëshime ndaj popullsisë shqiptare të viseve jugore<sup>75</sup>. Luigj Gurakuqi u kërkoi atdhetarëve të Toskërisë “të tunden e të zgjohen nga gjumi i rëndë...se nuk asht mirë për ta me i lanë vetëm vllaznit e tyne në luftën e shenjtë që kanë nisur për shpëtimin e atdheut...”<sup>76</sup>.

Përhapja e kryengritjes në shkallë të gjerë në viset e jugut, ndodhi për shkak se autoritetet lokale dhe komanda e ushtrisë osmane mori masa parandaluese jashtëzakonisht të rrepta kundër shqiptarëve. Qëllimi i këtyre masave ishte që me anën e terrorit të frikësoheshin banorët dhe në këtë mënyrë të pengohej përhapja e lëvizjes kryengritëse në këto anë. Shqiptarët e viseve të jugut mbetën në pozita pritmërie pasi nuk kishin shpresë se rrethet nacionaliste do të mund të realizonin një kryengritje të përgjithshme. Ata kishin dyshimin se shqiptarët ende nuk ishin në gjendje për të dëbuar me forcat e tyre sundimin turk nga trojet e tyre. Gjithashtu, ndonëse në rrethet nacionaliste pakënaqësia për qeverinë xhonturke ishte e madhe për shkak të shtimit të rasteve të grabitjeve, por një pjesë e tyre mendonte se gjendja nuk kishte arritur deri në atë shkallë sa të hidheshin në një kryengritje të tillë që synonte fitimin e autonomisë për të gjithë

<sup>73</sup> *Po aty*, Vj. 22-18-1886, Raport i konsullit a-h Rudnay, drejtuar kontit Aehrenthal, Durrës, 22 janar 1912.

<sup>74</sup> L. Zeza, *Çeta e Studentëvevet ...*, f. 58.

<sup>75</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-17-1787, Relacion i kryekonsullit a-h Bilinski, drejtuar ambasadorit Pallavicini në Stamboll, Janinë, 21 korrik 1912.

<sup>76</sup> Lek Gruda, “Kryengritja në Gegëri”, në *Liri e Shqipërisë*, nr. 46, Sofje, 18 qershor 1912, f. 2.

Shqipërinë, sikurse aspironin disa nacionalistë radikalë<sup>77</sup>. Meqenëse vala kryengritëse u përhap në pothuajse të gjithë krahinat shqiptare, arrihet në përfundimin se Kryengritja e vitit 1912 kishte karakter të përgjithshëm, por qendrat kryengritëse mbetën të izoluara dhe nuk patën të njëjtën gjatësi vale me atë që shpërtheu në Kosovë<sup>78</sup>. Në këto kushte, qeveria osmane e përqendroi vëmendjen në vilajetin e Kosovës, sepse në vilajetet e tjera nuk kishte ndonjë lëvizje të fuqishme kryengritëse<sup>79</sup>.

Deri në mesin e muajit korrik drejtuesit e kryengritjes në Kosovë arritën të ngrinin në këmbë me mijëra shqiptarë kundër qeverisë xhonturke, duke realizuar objektivin e parë që i kishin vënë vetes. Pas kësaj periudhe, lëvizja kryengritëse shfaqti probleme të theksuara si për sa i përket koordinimit të veprimeve kryengritëse, shtrirjes së saj dhe paraqitjes së kërkesave kombëtare. Meqenëse drejtuesit e lëvizjes kryengritëse shqiptare nuk arritën të përfitonin nga zgjerimi i valës kryengritëse, pa kaluar shumë kohë në mesin e kryengritësve filluan të shfaqeshin probleme të shumta. Për shkak të zgjerimit të radhëve të kryengritësve, largimit të tyre nga krahinat ku ata kishin ndikim, sasisë së pamjaftueshme të ndihmave të mbledhura nga shqiptarët e diasporës vihej re se gati gjysma e kryengritësve nuk kishin armë dhe se pjesa më e madhe e tyre vuanin nga mungesat e shumta në veshmbathje dhe sidomos në ushqime<sup>80</sup>. Ky problem ishte shfaqur edhe në kryengritjet e mëparshme, duke dëshmuar se lëvizjet kryengritëse shqiptare vuanin nga pikëpamja e organizimit.

I gjendur para vështirësive të shumta financiare për mbajtjen e kryengritësve, Hasan Prishtina u detyrua t'u kërkonte ndihmë disa shqiptarëve të pasur si Sait Hoxhës nga Shkupi, Haxhi Xhemal Agës nga Prishtina e të tjerëve, anëtarë të partisë "Liri e Marrëveshje". Kontributi në të holla i tyre i dha hov kryengritjes por njëkohësisht i krijoi mundësi këtij grupi shqiptarësh të zinte një vend të rëndësishëm në krye të kryengritjes, e cila pati rrjedhoja të rëndësishme në rezultatet e kryengritjes. Pasi ky grupim ndjeu se kishte forcuar pozitën e veta në mesin e kryengritësve, me kalimin e kohës, tendencat imponuese të tyre

<sup>77</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-11-1119, Raport i konsullit a-h Lejhanec, drejtuar kontit Berchtold në Vjenë, Vlorë, 28 shkurt 1912.

<sup>78</sup> "Nga Gjirokastra", në *Liri e Shqipërisë*, nr. 50, Sofje, 24 korrik 1912, f. 3.

<sup>79</sup> T. Abdyl, *Hasan Prishtina në Lëvizjen Kombëtare ...*, f. 119-120; R. Abdyl, *Lëvizja Kombëtare ...*, Libri 2, f. 288.

<sup>80</sup> N. Koleci, *Kryengritja e Përgjithëshme ...*, f. 79-80.

erdhën gjithnjë duke u zgjeruar. Qysh nga mesi i muajit qershor, një pjesë e këtij grupimi u shkëput përfundimisht nga bashkëpunimi me pjesën kryengritëse<sup>81</sup>.

Pas hyrjes së forcave kryengritëse në Prishtinë më 21 korrik, në duart e kryengritësve ishte e gjithë Kosova dhe shumë vise përreth saj dhe në vilajetin e Shkodrës<sup>82</sup>. Para drejtuesve të kryengritjes u shtruan dy detyra të rëndësishme. Detyra e parë ishte shkëputja e një pjese të kryengritësve nga programi itilafist dhe paraqitja para komisionit osman të 12 kërkesave të njohura të Kuvendit të Junikut, realizimi i të cilave do t'i siguronte vendit autonominë administrative. Detyra e dytë ishte që në bisedimet me komisionin qeveritar, përfaqësia e shqiptarëve të fliste në emër të të gjitha krahinave shqiptare dhe të mos lejonte që qeveria turke të bënte marrëveshje lokale me kryengritësit shqiptarë siç ndodhi më 1911. Gazeta "Dielli" paralajmëronte kryengritësit që të ishin vigjilentë, sepse liberalët, pasi të forconin pozitat, mund t'i harronin të gjitha<sup>83</sup>.

### **Bisedimet shqiptaro-osmane dhe "14 pikat e Hasan Prishtinës"**

Pas mesit të muajit korrik tek drejtuesit e lëvizjes kryengritëse pati një farë konfuzioni. Në këtë periudhë drejtuesit e Kryengritjes Shqiptare të vitit 1912 bënë disa gabime të njëpasnjëshme, të cilat i krijuan hapësirë veprimi palës kundërshtare dhe vështirësuan përmbushjen me sukses të qëllimit të kryengritjes. Tek një pjesë e mirë e drejtuesve të kryengritjes u krijua një gjendje vetëkënaqësie për suksesin e arritur deri atëhere. Në mesin e drejtuesve të kryengritësve të mbledhur në Prishtinë, u shfaqën dy qëndrime. Riza Bej Gjakova, Bajram Curri dhe krerë të tjerë të Gjakovës, përfaqësues të viseve të Dibrës, Elbasanit, Beratit e të tjerë kërkonin që të ndërmerrej një aksion energjik për realizimin e autonomisë. Për këtë qëllim, ata ishin të gatshëm të niseshin për në Shkup. Grupi tjetër, i përbërë nga Hasan Prishtina dhe kryesisht bejlerët e Prishtinës, mendonin se duhej të pritej ardhja e komisionit qeveritar dhe

<sup>81</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-6-632, Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, drejtuar konsull a-h Von Zambaur në Shkodër, Vjenë, 13 qershor 1912; N. Koleci, *Kryengritja e Përgjithëshme ...*, f. 80.

<sup>82</sup> *Hasan Prishtina – Përmbledhje dokumentesh ...*, f. 64; T. Abdyli, *Hasan Prishtina në Lëvizjen Kombëtare ...*, f. 117.

<sup>83</sup> *Dielli*, nr. 160, Boston Mass., 1 gusht 1912, f. 2.

të parashtroheshin kërkesat për rrëzimin e qeverisë xhonturke dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja parlamentare. Situata u acarua deri në atë shkallë sa Riza Bej Gjakova vendosi që së bashku me shtatë mijë burra të zbriste në Bresje në drejtim të Ferizajt<sup>84</sup>. Përfaqësues të opozitës si Qemal Beu nga Shkupi dhe Sali Beu që u rreshtuan përkrah grupit të dytë nuk dëshironin që shqiptarët të shfaqnin asnjë prirje autonomiste<sup>85</sup>.

Për realizimin e interesave kombëtare të shqiptarëve, forcat kryengritëse shqiptare taktikisht duhej të bashkëpunonin me “Lëvizjen e Oficerëve Shpëtimtarë” deri në rrëzimin e qeverisë xhonturke<sup>86</sup>. Urdhri i qeverisë për shmangien e çdo lloj konflikti të ushtrisë osmane me shqiptarët, u hapi rrugë kryengritësve për të rritur presionin dhe për të vendosur pushtetin në të gjithë territorin që gjendej nën kontrollin e tyre. Njëkohësisht, ai shkaktoi mosmarrëveshje dhe pështjellim ndërmjet grupeve të ndryshme të oficerëve në radhët e ushtrisë. Ky moment nuk u shfrytëzua si duhet nga drejtuesit shqiptarë, pasi komisioni qeveritar që erdhi në Kosovë për bisedime nuk kishte rrugë tjetër ose të plotësonte kërkesën për autonominë e Shqipërisë, ose shteti osman do të hynte në luftë me shqiptarët, të cilët gjendeshin tashmë në një pozitë të fortë<sup>87</sup>. Megjithëse në mesin e kryengritjes shqiptare ndihej nevoja e koordinimit të veprimeve me të gjithë komitetet kombëtare brenda dhe jashtë vendit, drejtuesit e rretheve nacionaliste shqiptare as nuk arritën të shkonin, por as nuk dërguan përfaqësuesit e tyre për të marrë pjesë në bisedimet me komisionin e qeverisë osmane<sup>88</sup>.

Qëndrimi refraktar i drejtuesve të qeverisë së re osmane ndaj plotësimit të kërkesave të kryengritësve shqiptarë u duk qartë që në fillim të bisedimeve të drejtuesve të kryengritjes me komisionin qeveritar të ardhur nga Stambolli, i përbërë nga Sulejman Pashë Kolonja dhe Ali Danish Bej Gjinolli, të cilit në fund iu shtua edhe mareshalli Ibrahim Pasha. Bisedimet nisën në Prishtinë më 27 korrik. Në mesin e përfaqësuesve të kryengritësve u krijuan dy rryma të ndryshme mendimesh. Nga njëra anë ishin autonomistët, të përbërë nga Riza Bej Gjakova, Hasan Prishtina, Jahja Aga, Musa Efendi Prizreni, të cilët

<sup>84</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 ...*, dok. 313, f. 419; dok. 322, f. 428.

<sup>85</sup> *Po aty*, dok. 319, f. 426.

<sup>86</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-6-641, Telegram i konsullit a-h Tahy, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Mitrovicë, 21 korrik 1912.

<sup>87</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 ...*, dok. 326, f. 432; dok. 330, f. 435.

<sup>88</sup> R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare ...*, Libri 2, f. 340.

kërkonin që kërkesat të formuloheshin sipas platformës autonomiste, nga ana tjetër ishin reformistët, përfaqësues të qyteteve kryesore të vilajetit të Kosovës, të cilët kërkonin që të bëheshin lëshime në pikat thelbësore të kërkesave shqiptare, pasi ato nënkuptonin shkëputjen nga Perandoria Osmane<sup>89</sup>. Në këtë moment, grupi i parisë shqiptare me në krye Isa Boletinin, i konsolidoi pozitat e tij në mesin e kryengritësve<sup>90</sup>.

Me mjaft vështirësi u arrit që të gjendej një gjuhë kompromisi midis dy rrymave shqiptare. Më në fund, drejtuesit e kryengritësve arritën të formulonin disa kërkesa, të cilat ishin: shpërndarja e parlamentit brenda 48 orëve, në të kundërt do të marshohej drejt Shkupit e më tej; liri e mbajtjes së armëve; shërbimit ushtarak në pjesën evropiane të Perandorisë; hapja e shkollave në marrëveshje me pushtetin osman; zgjedhja e nëpunësve mundësisht shqiptarë; hedhja poshtë e idesë për kufijtë e Shqipërisë brenda Perandorisë Osmane. Këto kërkesa shënonin një tërheqje nga platforma kombëtare e shqiptarëve<sup>91</sup>. Komisioni osman hodhi poshtë menjëherë kërkesën e parë të shqiptarëve, pasi ajo binte në kundërshtim me kushtetutën. Në këto momente, drejtuesit shqiptarë morën njoftimin se Mali i Zi kishte pushtuar disa pozicione, duke përfshirë edhe Beranën në veri<sup>92</sup>.

Zgjatja në kohë e bisedimeve ishte një taktikë e qeverisë osmane që shkonte në disfavor të shqiptarëve. Ajo synonte realizimin e dy objektivave nga ana e kësaj qeverie: së pari, të përpiqej që të bënte për vete një pjesë të drejtuesve të kryengritjes; së dyti, të fitonte kohë për të konsoliduar pozitën e saj dhe më pas për t'i kërcënuar kryengritësit që të tërhiqeshin nga kërkesat e tyre autonomiste. Problemi bëhej edhe më i mprehtë për shkak të mungesës së përfaqësuesve të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut, e cila i shkonte për shtat komisionit të qeverisë osmane. Drejtuesit e kryengritjes humbën mjaft kohë pa bërë asgjë, duke pritur të fillonin bisedimet me palën osmane, në vend që të hartonin një plan të ri veprimi në rrethanat e reja që u krijuan për shqiptarët. Hartimi i një platforme të re veprimi e cila të tejkalonte problemet e krijuara, nuk u arrit që të realizohej për shkak të divergjencave që u shfaqën ndërmjet Riza Bej Kryeziut, Isa Boletinit, Bajram Currit dhe përfaqësuesve të

<sup>89</sup> Z. Cana, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare ...*, f. 257-258.

<sup>90</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 ...*, dok. 370, f. 476; dok. 373, f. 480-488.

<sup>91</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 ...*, dok. 333, f. 436-438; Akte të Rilindjes Kombëtare..., dok. 161, f. 246-247.

<sup>92</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 ...*, dok. 350, f. 456.

qyteteve të sanxhakut të Prishtinës, si Xhemal Aga, Iljaz Aga por dhe të Hasan Prishtinës nga ana tjetër<sup>93</sup>. Agjentët serbë arrinin në përfundimin se “Hasan Prishtina është demoni ynë. Ai ose duhej futur në grindje me [Isa] Boletin, ose t’i hiqet koka në njëfarë mënyre me mjeshtri”<sup>94</sup>.

Hasan Prishtina vendosi që t’u drejtonte një thirrje të gjithë shqiptarëve. Thirrja e titulluar: “Vëllazën të dashtun” e nënshkruar nga “Atdhetarët e vërtetë të Kosovës” u publikua në shtyp më 30 korrik. Në të u kërkohej shqiptarëve të të katër vilajeteve që të dërgonin “njerëz atdhetarë e me rëndësi” si përfaqësues të tyre në një mbledhje ku do të vendosej për të drejtat dhe kërkesat që do t’i drejtoheshin qeverisë<sup>95</sup>.

Më 1 gusht në Prishtinë arriti Ibrahim Pasha, i cili nisi menjëherë raundin e dytë të bisedimeve me drejtuesit kryesorë të kryengritjes. Hasan Prishtina u shpreh se qeveria e re duhej të dënonte ashpër barbarizmat e xhonturqve ndaj shqiptarëve në vitet 1909-1910 dhe shpërdorimet e kryera nga qeveria xhonturke gjatë zgjedhjeve parlamentare. Ai theksoi se shqiptarët të bashkuar, kërkonin shpërndarjen e parlamentit të paligjshëm. Ibrahim Pasha hodhi poshtë këtë *conditio sine qua non* [kusht i domosdoshëm – S. K.] të shqiptarëve me argumentin se kjo kërkesë duhej të zgjidhej në rrugë kushtetuese. Riza Bej Gjakova, Bajram Curri dhe Mehmet Pashë Dërralla ngulën këmbë në kërkesat e tyre dhe kërcënuan se do të marshonin për në Ferizaj, pasi aty ishte vendi tradicional i kuvendeve të shqiptarëve. Ibrahim Pasha siguroi mbështetjen e grupit utilafist shqiptar të shtatë kazave të Prishtinës me në krye Xhemal Agë Agushin si dhe të sanxhakut të Senicës e të Plevljes, të cilët vendosën që të presin përgjigjen e qeverisë osmane, pasi në Kosovë, shqiptarët ndiheshin zot të vendit të tyre<sup>96</sup>.

Pozita e Hasan Prishtinës u bë shumë më e vështirë se më parë, madje tashmë ishte në pikëpyetje edhe jeta e tij. Për shkak të mendimeve të ndryshme që u shfaqën në mesin e drejtuesve, si dhe mungesës së përgjigjes nga qeveria, kryengritësit vendosën t’i drejtoheshin Ferizajt. Kjo lëvizje alarmoi qeverinë osmane, e cila nxori më 5 gusht 1912 dekretin për shpërndarjen e parlamentit. Shpërndarja e Parlamentit

<sup>93</sup> *Po aty*, dok.293, f. 396; dok. 294, f. 397; R. Abdyli, *Lëvizja Kombëtare...*, Libri 2, f. 350.

<sup>94</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 ...*, dok. 373, f. 488.

<sup>95</sup> “Vëllazën të dashtun”, në *Liri e Shqipërisë*, nr. 50, Sofje, 24 korrik 1912, f. 1.

<sup>96</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-20-2087, Raport i konsullit a-h Tahy, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Mitrovicë, 4 gusht 1912.

Osman ishte faktori kryesor që ndryshoi rrjedhën e zhvillimit me sukses të kryengritjes shqiptare. Kjo lëvizje i dha mundësi qeverisë së re që të hiqte qafe opozitën e fortë brenda parlamentit, të forconte kohezionin e brendshëm turk dhe t'i kishte duart e lira me shqiptarët. Me këtë akt, qeveria plotësoi kërkesat kryesore të itilafistëve dhe të “oficerëve shpëtimtarë”. Largimi i këtyre të fundit nga lëvizja, krijoi vështirësi për pjesën e kryengritësve shqiptarë që kërkonin autonominë<sup>97</sup>, pasi rezikonin të mbeteshin ndërmjet dy zjarreve.

Në këto rrethana të vështira që u krijuan, me sa duket Hasan Prishtina mendoi se rruga më e drejtë ishte zhvillimi i negociatave të shpejta me palën osmane. Më 9 gusht 1912, Hasan Prishtina, në emër të kryengritësve shqiptarë i dorëzoi Ibrahim Pashës një memorandum, i cili përmbante 14 kërkesa, që njihen ndryshe si “14 kërkesat e Hasan Prishtinës”<sup>98</sup>. Duke krahasuar memorandumin e paraqitur nga Hasan Prishtina me përmbajtjen e kërkesave të parashtruara në Junik dhe në Memorandumin e Greçës, arrijmë në këto mendime:

*Së pari*, në dokumentin e Hasan Prishtinës kishte shtatë kërkesa që ishin për nga përmbajtja të njëjta me kërkesat e parashtruara në dy memorandumet e mëparshme nga ana e shqiptarëve.

*Së dyti*, në këtë dokument pati disa kërkesa që dilnin jashtë platformës së mëparshme të shqiptarëve, siç ishte pika 3, ku flitej për vënien në zbatim në disa krahina të ligjit të maleve (xhibalit); pika 6, në të cilën kërkohej hapja e shkollave teologjike në vendet ku kishte më tepër nevojë; dhe pika 12, në të cilën kërkohej shpallja e amnistisë për të gjithë komandantët, oficerët, nëpunësit dhe ushtarët që kishin braktisur ushtritë dhe detyrat e tyre gjatë kohës së kryengritjes.

*Së treti*, shtatë pika të platformës së kërkesave (1, 3, 4, 6, 11, 13, 14) me sa duket përmbajnë dëshirat e masës së thjeshtë dhe të drejtuesve të saj dhe ishin një lloj koncesioni ndaj oficerëve dhe nëpunësve xhonturq, për lëshimet e tyre gjatë periudhës së kryengritjes. Ndërkohë, shtatë pika të programit (2, 5, 7, 8, 9, 10, 12) ka të ngjarë të jenë parashtruar nga drejtues të arsimuar që morën pjesë në kryengritje, pasi përmbajtja e tyre tregon se ata nuk dëshironin t'i parashtronin hapur qëllimet e tyre<sup>99</sup>.

<sup>97</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 ...*, dok. 389, f. 505.

<sup>98</sup> *Akte të Rilindjes Kombëtare ...*, dok. 166, f. 251-252; H. Prishtina, *Nji shkurtim kujtimesh ...*, f. 28-30.

<sup>99</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-20-2079, Raport i nënkonsullit a-h Tahy, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Mitrovicë, 11 gusht 1912.

*Së katërti*, në dokumentin e paraqitur nga Hasan Prishtina duhet pranuar se ka një tërheqje nga kërkesa themelore e nacionalizmit shqiptar për njohjen zyrtare të kombit shqiptar, pasi kjo kërkesë ishte e sigurtë që do të hidhej poshtë nga Porta e Lartë. Kjo tërheqje shpjegohet edhe me zhvillimet politike e ushtarake në Gadishullin e Ballkanit, në radhë të parë me rrezikun që sillte për vendin afrimi i shpërthimit të Luftës Ballkanike<sup>100</sup>. Ajo dëshmon faktin se rryma e mendimit për shpalljen në mënyrë të njëanshme të autonomisë ishte ende e pakët në numër. Mënyra e artikullimit të frazave të memorandumit, lënia mënjanë e çështjes së taksave, por përfshirja në të e kërkesës së shpërndarjes së armëve, duket se në pamje të parë nuk të thonë asgjë, por nga ana tjetër këto ishin indikacione që tregonin se aspirata e nacionalistëve shkonte shumë më larg se sa përmbante ky program. Nga mënyra se si është e formuluar pika 10 si dhe disa pika të tjera të platformës, duket se kemi të bëjmë me një tërheqje taktike nga ana e nacionalistëve shqiptarë. Formimi i nahijeve apo shprehur ndryshe forcimi i pushtetit vendor ishte një kërkesë sa largpamëse po aq edhe moderne, pasi ajo mbante brenda saj dy parime të rëndësishme: së pari, meqenëse popullsia e nahijeve në katër vilajetet e pretenduara nga nacionalizmi shqiptar, përbëheshin në shumicë nga shqiptarët, ishte logjike se vendimet do të merreshin nga shumica e banorëve; së dyti, formimi i nahijeve nënkuptonte zbatimin e parimit të decentralizimit nga pushteti qendror. Pikërisht kjo ide, u përpunua nga diplomacia austro-hungareze, e cila u bë pjesë e shkëmbimeve të ideve me pjesën tjetër të Fuqive të Mëdha si dhe iu paraqit Portës së Lartë<sup>101</sup>.

Përmbajtja e kërkesave të parashtruara prej shqiptarëve, shënon kalimin nga ideja e autonomisë e shprehur në letër, drejt një veprimi praktik dhe pragmatik për realizimin e këtij statusi për shqiptarët. Në këtë këndvështrim, kërkesat e shqiptarëve të paraqitura nga Hasan Prishtina, e orientuan vëmendjen e shqiptarëve në disa drejtime të rëndësishme për interesat e tyre kombëtare, si: krijimin e një administrate publike të përbërë nga nëpunës shqiptarë, të cilët njihnin mirë gjuhën dhe zakonet e shqiptarëve; mbrojtjen e viseve etnike shqiptare përmes kërkesës për kryerjen e shërbimit ushtarak të shqiptarëve në Shqipëri dhe Maqedoni dhe pajisjen e tyre me armë moderne; themelimin dhe hapjen e shkollave

<sup>100</sup> *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. II, f. 498.

<sup>101</sup> HHStA.PA.A. në *AIH*, Vj. 22-22-2239, Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme, Berchtold, drejtuar përfaqësuesve a-h në Shën Petërburg, në Berlin, në Londër, në Paris, në Romë, në Stamboll dhe në Bukuresht, Vjenë, 13 gusht 1912.

të reja në të katër vilajetet me shumicë shqiptare, duke përdorur gjuhën shqipe në programet mësimore dhe në të gjitha nivelet e shkollimit; zhvillimi i sektorëve të rëndësishëm të ekonomisë si atij të tregtisë, bujqësisë, punëve publike dhe i rrjetit të komunikimit dhe transportit publik.

Këto kërkesa të artikuluar në mënyrë të tërthortë, të shtyjnë drejt mendimit se synimi i nacionalistëve shqiptarë ishte që në mënyrë latente, të arrihej në praktikë një lloj autonomie për shqiptarët. Kalimi drejt këtij kursi politik veprimi nuk flet për ndonjë dobësi apo gabim nga ana e Hasan Prishtinës, siç është shkruar më herët<sup>102</sup>, por ajo dëshmon për një qartësi dhe largpamësi politike nga ana e shqiptarëve nëse mbahen parasysh disa faktorë objektivë: së pari, rrethanat e vështira që u krijuan për shqiptarët për shkak të fillimit të veprimeve luftarake në veri të viseve shqiptare nga ana e shteteve fqinje<sup>103</sup>; së dyti, përçarja, mungesa e organizimit dhe e një platforme të përbashkët politike në mesin e nacionalistëve shqiptarë si dhe presioni i një pjese të parisë shqiptare, të cilët pas shpërndarjes së Parlamentit Osman mendonin se ishin realizuar kërkesat e shqiptarëve; së treti, forcimi i pozitës së qeverisë së re osmane dhe mungesa e vazhdueshme e mbështetjes nga Fuqitë e Mëdha për popullin shqiptar.

Nga data 4 deri më 15 gusht, duke parë se kërkesat e shqiptarëve nuk u plotësuan, rreth 35 mijë kryengritës shqiptarë marshuan drejt Shkupit. Përfaqësuesi osman Ibrahim Pasha deklaroi më 18 gusht 1912 se qeveria osmane i pranonte 12 nga 14 kërkesat e paraqitura nga ana e shqiptarëve. Çështja e gjykimit të dy kabineteve xhonturke ishte kompetencë e parlamentit të ri, ndërsa armatimi i shqiptarëve do të bëhej më vonë. Në rast se shqiptarët do të kundërshtonin, Xhavit Pasha ishte urdhëruar që t'u dilte shqiptarëve përpara me forcat e artillerisë. Në mbledhjen e organizuar nga Hasan Prishtina ku ishin të pranishëm Riza Beu, Bajram Curri, Isa Boletini, Idriz Seferi e të tjerë u diskutua mbi ofertën osmane. Një pjesë e tyre pati vërejtje veçanërisht për mënyrën e rikthimit të armëve dhe çështjen e alfabetit, por ata e pranuan marrëveshjen e ofruar,

<sup>102</sup> Irena Grigorjevna Senkieviç, *Osvoboditelnoe dvizhenije Albanskogo naroda v 1905-1912*, Moskva: 1959, f. 236; Kristo Frashëri, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (28 nëndor 1912)*, Botim' i Ministrisë s' Arësimit dhe Kulturës, Tiranë: 1957, f. 16.

<sup>103</sup> F. Musaj, *Isa Boletini ...*, f. 150-151.

e cila parashikonte vendosjen e armëve në depo në të gjitha kazatë, që populli t'i merrte në çdo moment kur rrezikohej atdheu<sup>104</sup>.

Plotësimi vetëm i një pjese të kërkesave të shqiptarëve, mungesa e pasqyrimit të tyre në një dokument zyrtar nga qeveria osmane si dhe lënia mënjanë e kërkesave më të rëndësishme autonomiste shqiptare dëshmonte për dobësinë e nacionalizmit shqiptar. Dobësia kryesore e organizimit të kryengritjes e ka zanafillën qysh në mbledhjen e Taksimit. Drejtuesit e kryengritjes u mjaftuan me çlirimin e një pjese të viseve shqiptare, hapjen e burgjeve, të depove të armëve, dëbimin e disa nëpunësve të padëshiruar, ngritjen e disa komisioneve administruese, pa menduar politikisht më larg. Kjo u krijoi mundësi autoriteteve osmane që të kontrollonin situatën në viset shqiptare në tërësi, por edhe mendimet brenda drejtuesve të kryengritjes.

Përfundimet e kësaj kryengritjeje nuk kënaqën nacionalistët shqiptarë sepse ajo nuk u siguroi shqiptarëve një vilajet të bashkuar dhe autonom<sup>105</sup>. Mosrealizimi i qëllimit kombëtar, nxiti menjëherë tek një pjesë të nacionalizmit shqiptar si Luigj Gurakuqi kritika për rezultatet e kryengritjes. Megjithëse gjatë zhvillimit të kryengritjes një pjesë e tyre qëndroi kryesisht jashtë atdheut, ata mendonin se mosrealizimi i kërkesës për autonomi ishte rezultat i gabimeve të vetë drejtuesve shqiptarë, të cilët nuk ishin marrë vesh vetë drejtpërdrejt me komisionin e qeverisë, pa përzier fanatikët e Prishtinës, të Shkupit e të Tetovës që ishin “më turq se turqit” dhe se përfaqësuesit e viseve të tjera nuk nxituan të dërgonin përfaqësuesit e tyre në Kosovë që numri i atdhetarëve të shtypte fuqinë e fanatikëve<sup>106</sup>.

Pavarësisht mangësive dhe dobësive që pati Kryengritja e Shqiptare e vitit 1912, ajo ishte lëvizja më e madhe dhe më e organizuar kombëtare e shqiptarëve që nga periudha e Lidhjes së Prizrenit. Ajo i dha një goditje të fortë pushtetit osman në tokat shqiptare. Kjo kryengritje vinte pas tre kryengritjeve të njëpasnjëshme të shqiptarëve dhe dëshmoi se flaka e kryengritjes së shqiptarëve të fillimit të shekullit XX, qëndronte e ndezur dhe se ato përmbanin në thelb kërkesa me karakter kombëtar. Ajo kishte ndryshime të rëndësishme në disa aspekte thelbësore. Nëse kryengritjet e

<sup>104</sup> R. Abdyl, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare ...*, Libri 2, f. 390-391.

<sup>105</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 ...*, dok. 395, f. 512.

<sup>106</sup> *Qeveria e Përkohëshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (nëndor 1912 - janar 1914)*, përgatitur për botim nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Shtetërore të RPSH, Tiranë: 8 Nëntori, 1963, f. 24-25.

mëparshme shpërthenin në mënyrë spontane dhe më pas trupëzoheshin me kërkesa politike të hartuara nga elita politike shqiptare, ideja për Kryengritjen e vitit 1912 lindi tek elita politike dhe u përhap më pas prej saj tek popullsia shqiptare. Kryengritja e vitit 1912 pati një shtrirje më të gjerë në krahinat shqiptare; në të morën pjesë shqiptarë të besimeve të ndryshme fetare; ajo nuk u shtyp me forcën e armëve nga ushtria osmane; kjo kryengritje pati një shtab drejtues, i cili i orientoi shqiptarët drejt autonomisë në kuadër të Perandorisë Osmane. Megjithëse Kryengritja e vitit 1912 shfaqti edhe dobësi, ato nuk çonin peshë përballë faktit se çështja e realizimit të autonomisë ishte shtruar në rendin e ditës. Nëse Porta e Lartë do të kundërshtonte më tej zbatimin e kërkesave të shqiptarëve, tashmë të armatosur, ajo nuk do të ishte më në gjendje të kundërshtonte autonominë për shqiptarët, për rrjedhojë, edhe Fuqitë e Mëdha nuk do të mund të dilnin kundër autonomisë së Shqipërisë<sup>107</sup>.

### *S u m m a r y*

#### ON SOME ISSUES OF THE ALBANIAN UPRISING IN 1912

The Albanian uprising of 1912 represents the culmination of the Albanian autonomist movement and final stage of the efforts of Albanian nationalism and this nation under the Ottoman Empire. The main factor that prompted Albanians to undertake the uprising of 1912 was the difficult situation in which they were after the victory of the Young Turk Revolution. The Ottoman ideology and centralizing policy taken by the Young Turks was the main factor for the aggravation of relations between two sides. The plan for the organization of the uprising adopted during a meeting of some key Albanian personalities in Taksim (Istanbul, Turkey) presented some weaknesses in itself because the participants did not analyze and presented possible scenarios of the upcoming uprising. On the other hand, some of the organizers of the uprising, as soon as arrived in Albania became more interested on the providing themselves as deputies in the Ottoman parliament and “forgot” the meeting’s decisions taken in Taksim.

---

<sup>107</sup> *Kryengritja shqiptare e vitit 1912 ...*, dok. 438, f. 567; dok. 444, f. 574.

Unlike expected Austro-Hungary was against the Albanian uprising. It was to maintain the “status quo” of the Ottoman Empire. The Serbian government came about and tried to stay near to the leaders of the Albanian uprising in Kosova in order to incite against the Ottoman state and to prepare suitable ground for the invasion of these regions by her.

From the meeting of Junik (Kosova) emerged two main currents of thought. The first current, maintained that the Albanians had to enlarge the insurrection for announcing the autonomy. Another current comprised of representatives, who were against the Albanian uprising or at least had joined the insurgency just to remove from the power the Young Turk government. The wording of the Albanians claims at the meeting of Junik to the Ottoman government was conducted in a more synthetic, with a clearer and more straightforward language compared to the text of the Memorandum of Greçe (Upper Shkodra). In our view, the cooperation of the Albanians with the Ottoman officers’ movement went through two stages. In the second stage, from the second half of July to August 1912, the cooperation of Albanians with Ottoman army officers went more in favor of the latter.

The uprising extended from Presheva, Gjilan Mitrovica in the north to Korça, Kolonja and Chameria region in the south, but a greater intensity of Albanian uprising of 1912 remained in parts of Kosova. There were two main currents among the leaders of the uprising throughout the negotiations with the Ottoman government commission. The first current was composed of autonomy’s representatives; the second one consisted of reformists, who required putting aside the essential points of Albanian demands. On August 9, 1912, due to internal and external pressure, Hasan Prishtina gave a memorandum on behalf of the Albanians to Ibrahim Pasha, the head of the Ottoman commission which contained 14 requests. From the way how was formulated this platform, it seems that there is a tactical retreat by the Albanian nationalists. The contention of requests marks the transition from the idea of autonomy expressed in the paper, towards a practical and pragmatic action to achieve this status for Albanians. But, at the same time, it proves that Albanian nationalism was still weak because it lacked a unique attitude.